



International  
Labour  
Organization

# ► Raporti Botëror për Mbrojtjen Sociale 2020-22



Raporti Shoqërues  
Rajonal për Evropën  
Qendrore dhe  
Lindore dhe Azinë  
Qendrore

Copyright © Organizata Ndërkombëtare e Punës 2021  
*Botimi i parë 2021*

Botimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës gëzojnë të drejtën e autorit sipas Protokollit 2 të Konventës Universale të së Drejtës së Autorit. Megjithatë, pjesë të shkurtra nga to mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të tregohet burimi. Për të drejtën e riprodhimit ose përkthimit, aplikimi duhet të bëhet tek Byroja e Botimeve të ILO-s (Të Drejtat dhe Lejet), International Labour Office, CH -1211 Geneva 22, Switzerland, ose nëpërmjet postës elektronike: [rights@ilo.org](mailto:rights@ilo.org). Zyra Ndërkombëtare e Punës mirëpret aplikime të tilla.

Bibliotekat, institucionet dhe përdoruesit e tjerë të regjistruar në organizata që kanë të drejta riprodhimi, mund të bëjnë fotokopje në pajtim me licencën lëshuar atyre për këtë qëllim. Vizitoni [www.ifrro.org](http://www.ifrro.org) për të gjetur organizatën me të drejta riprodhimi në vendin tuaj.

---

ISBN 978-92-2-035886-3 (web PDF)

Citoni këtë publikim si: Zyra Ndërkombëtare e Punës. *Raporti Botëror i Mbrojtjes Sociale 2020–22: Raport Rajonal shoqëruar për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Azinë Qendrore*. Gjenevë: ILO, 2021.

---

Dizenjot në Botimet e ILO-s, të cilat janë në përputhje me praktikën e Kombeve të Bashkuara, dhe paraqitja e materialit aty nuk nënkupton shprehjen e ndonjë opinionit të cfarëdolloji nga Zyra Ndërkombëtare e Punës në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, rajoni a territori ose të autoriteteve të tyre, ose në lidhje me përcaktimin e kufijve të tyre.

Përgjegjësia për opinionet e shprehura në artikujt, studimet dhe kontributet e nënshkruara është vetëm e autoreve, dhe botimi nuk përbën miratimin e Zyrës Ndërkombëtare të Punës për opinionet e shprehura aty.

Referenca për emra kompanish, produktesh dhe procesesh tregtare nuk nënkupton njohjen e tyre nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, dhe çdo mospërmendje e ndonjë kompanie të veçantë, produkti ose procesi tregtar, nuk është shenjë e mosaprovimit.

Për më shumë informacione për publikimet e ILO apo ato dixhitale, vizitoni faqen tonë në internet: [www.ilo.org/publns](http://www.ilo.org/publns).

---

Foto e Kopertinës © Dakota Corbin / unsplash

# parathënie

Ky raport shoqëruës rajonal për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Azinë Qendrore synon të plotësojë *Raportin Botëror për Mbrojtjen Sociale 2020-22. Mbrojtja Sociale në Udhëkryq - në Kërkim të një të Ardhmeje më të Mirë*. Raporti shoqëruës rajonal përbëhet nga dy pjesë. Së pari ai paraqet "Perspektivën Globale", pjesë e shkëputur nga raporti kryesor, dhe përshkruan zhvillimet e fundit në sistemet e mbrojtjes sociale në mbarë botën. Më pas nxjerr në pah zhvillimet kryesore, sfidat dhe prioritetet për mbrojtjen sociale në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Azisë Qendrore nga perspektiva e ciklit jetësor.

Ndërkohë që në vendet e rajonit sistemet gjithëpërfshirëse të mbrojtjes sociale janë krijuar tashmë, në nivel nënrajonal vihen re ndryshime të konsiderueshme me mungesa të theksuara që lidhen me mbulimin ligjor dhe efektiv, por edhe me uljen e përshtatshmërisë dhe pakësimin e investimeve për mbrojtjen sociale. Në të gjitha vendet, mbrojtja sociale ka luajtur rol jetik për përballimin e krizës së shkaktuar nga COVID-19. Megjithatë, kriza ka zbuluar mangësi sa i takon mbulimit, përshtatshmërisë dhe gjithëpërfshirjes në sistemet ekzistuese të mbrojtjes sociale të cilat burojnë nga problemet e qenësishme që mbizotërojnë në botën aktuale të punës. Prandaj, ky raport i nxit vendet që të përmirësojnë ofertën e mbrojtjes sociale duke e shtrirë mbulimin e punëtorëve në të gjitha llojet e punësimit; të zgjerojnë hapësirën fiskale dhe të caktojnë burime të mjaftueshme për ta financuar atë; të forcojnë kapacitetet e agjencive që mbikëqyrin administrimin e saj dhe të përmirësojnë konsensusin kombëtar për mbrojtjen sociale nëpërmjet dialogut social. Ndjekja e këtyre veprimeve të rëndësishme në nivel politikash do të përfaqësonte një qasje dhe perspektivë afatgjatë drejt së ardhmes së mbrojtjes sociale.



Heinz Werner Koller

Drejtor Rajonal  
i Zyrës Rajonale të ILO-s  
për Evropën dhe Azinë Qendrore



# përmbajtja

Parathënie	1
Shkurtesat	6
Falenderime	7
<b>1. Perspektiva Globale</b>	<b>9</b>
<b>2. Mbrojtja sociale në udhëkryq në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Azinë Qendrore</b>	<b>16</b>
<b>3. Mbulimi i mbrojtjes sociale: Trendet dhe perspektiva rajonale</b>	<b>17</b>
3.1. Mbrojtja e popullsisë në moshë pune: Mesi i munguar në rritje	20
3.2. Mbrojtja e fëmijëve dhe mbështetja e familjeve	23
3.3. Mbrojtja e shëndetit social	25
<b>4. Reagimi i mbrojtjes sociale ndaj pandemisë COVID-19</b>	<b>26</b>
<b>5. Përfundimi: Drejt një sistemi gjithëpërfshirës dhe rezilient të sigurimeve shoqërore</b>	<b>32</b>
Referencat	34

## Lista e kutive

---

1.	Reforma e kujdesit shëndetësor në Ukrainë	25
2.	Përmirësimi i reformave dhe mënyrës së ofrimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale duke përdorur sistemet elektronike për menaxhimin e informacionit në Azerbajxhan: <i>DOST</i> - një sportel i vetëm për shërbimet sociale	29
3.	Përmirësimi i reformave dhe mënyrës së ofrimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale duke përdorur sistemet elektronike për menaxhimin e informacionit në Shqipëri: Regjistri Elektronik Kombëtar, nxitja e zbatimit të reformave të ndihmës sociale, aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit	29

## Lista e figurave

---

1.	Treguesi i OZhQ 1.3.1: Mbulimi efektiv me mbrojtje sociale, vlerësimet globale dhe rajonale, sipas grupit të popullsisë, për vitin 2020 ose për vitin më të fundit në dispozicion	11
2.	Treguesi i OZhQ 1.3.1: Mbulimi efektiv me mbrojtje sociale, vlerësimet rajonale dhe nënrajonale, sipas grupit të popullsisë, për vitin 2020 ose për vitin më të fundit në dispozicion	18
3.	Mbulimi efektiv për mbrojtjen e pleqërisë: Përqindja e popullsisë në moshë pune të moshës 15+ vjeç e mbuluar nga skemat e pensioneve, sipas statusit të fuqisë punëtore, sipas rajonit, nënrajonit dhe gjinisë, për vitin 2020 ose për vitin më të fundit në dispozicion	19
4.	Mbulimi efektiv për mbrojtjen e pleqërisë: Përqindja e popullsisë në moshë pune të moshës 15+ vjeç e mbuluar nga skemat e pensioneve, sipas statusit të fuqisë punëtore dhe gjinisë, për vendet e zgjedhura, për vitin 2020 ose për vitin më të fundit në dispozicion	20
5.	Treguesi i OZhQ 1.3.1 për mbulimin efektiv për mbrojtjen nga papunësia: Përqindja e të papunëve që marrin përfitime në para, sipas rajonit, nënrajonit dhe nivelit të të ardhurave, për vitin 2020 ose për vitin më të fundit në dispozicion	21
6.	Treguesi i OZhQ 1.3.1 për mbulimin efektiv të grupeve të cënueshme të popullsisë: Përqindja e popullsisë në nevojë që merr ndihmë sociale, sipas rajonit dhe nënrajonit, për vitin 2020 ose për vitin më të fundit në dispozicion	22
7.	Treguesi i OZhQ 1.3.1 për mbulimin efektiv të fëmijëve dhe familjeve: Përqindja e fëmijëve të moshës 0-14 vjeç që marrin përfitime në para për fëmijët ose familjet, sipas rajonit, nënrajonit dhe nivelit të të ardhurave, për vitin 2020 ose për vitin më të fundit në dispozicion	23

## Lista e tabelave

---

1.	Humbjet e orëve të punës dhe humbjet e të ardhurave nga krahu i punës sipas rajonit, 2020	26
2.	Mbrojtja sociale dhe reagimi i vendeve të punës ndaj COVID-19	27
3.	Masat fiskale të lidhura me COVID-19 gjatë vitit 2020, për vendet e përzgjedhura (përqindja e PBB-së)	31



# shkurtesat

SHQ	Shqipëria
ARM	Armenia
AZE	Azerbajxhani
BeH	Bosnja dhe Hercegovina
BJELL	Bjellorusia
AQ	Azia Qendrore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
DOST	Agjencia për Sigurime Sociale të Qëndrueshme dhe Operative (Azerbajxhan)
EL	Evropa Lindore
ZETL	Zona Evropiane e Tregtisë së Lirë
BE	Bashkimi Evropian
FBeH	Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GJEO	Gjeorgjia
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KAZ	Kazakistani
KGZ	Kirgistani
MOLD	Republika e Moldavisë
MV	Maqedonia e Veriut
MiZ	Mali i Zi
n/a	jo i disponueshëm
ShShKU	Shërbimi Shëndetësor Kombëtar i Ukrainës
RS	Republika Srpska
RUS	Federata Ruse
NS	ndihma sociale
OZHq	Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm
MS	mbrojtja sociale
SRB	Serbia
KSSH	Kërkimi për Sigurimet Shoqërore
TAXh	Taxhikistani
UKR	Ukraina
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët



# falenderime

Ky raport rajonal u përgatit nga Kenichi Hirose, Specialist i Lartë për Mbrojtjen Sociale, Ekipi i Mbështetjes Teknike për Punën e Denjë dhe Zyra Kombëtare për Evropën Qendrore dhe Lindore, dhe Jasmina Papa, Specialiste për Mbrojtjen Sociale, Ekipi i Mbështetjes Teknike për Punën e Denjë dhe Zyra Kombëtare për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore. Kontribute dhe komente janë marrë edhe nga kolegët në selinë e ILO-s (sipas rendit alfabetik): Christina Behrendt, Ana Carolina de Lima Vieira, Victoria Giroud-Castiella, Valeria Nesterenko, Ian Orton, Shahra Razavi, Fabio Durán Valverde dhe Zhiming Yu. Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë edhe për Gillian Somerscales për redaktimin e këtij raporti rajonal.



# 1 Perspektiva Globale

Megjithë përparimin e evidentuar gjatë viteve të fundit sa i takon zgjerimit të mbrojtjes sociale në shumë pjesë të botës, në momentin e përhapjes së pandemisë COVID-19, shumë vende ishin ende duke u përballur me sfida të konsiderueshme që kishin të bënin me kthimin në realitet për të gjithë të së drejtës së njeriut për të përfituar nga sigurimet shoqërore. Ky seksion paraqet një pasqyrë globale të progresit të bërë në të gjithë botën gjatë dhjetëvjeçarit të fundit në aspektin e zgjerimit të mbrojtjes sociale dhe ndërtimit të sistemeve të mbrojtjes sociale të bazuara tek të drejtat, duke përfshirë këtu garancitë bazë të sigurimeve shoqërore, si dhe shtjellon ndikimin e pandemisë COVID-19. Në këtë mënyrë, raporti jep një kontribut të rëndësishëm në strukturën e monitorimit të Programit 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Pesë janë mesazhet që burojnë nga raporti:

***Pandemia ka eksponuar pabarazi të thella dhe mangësi të konsiderueshme sa i takon mbulimit, gjithëpërfshirjes dhe përshtatshmërisë së mbrojtjes sociale në të gjitha vendet.*** Sfidat e përhapura si nivelet e larta të pasigurisë ekonomike, varfëria e vazhdueshme, rritja e pabarazisë, informaliteti i gjerë dhe kontrata e brishtë shoqërore janë përqesuar nga COVID-19. Kriza ka nxjerrë në dritë edhe çënueshmërinë e miliarda njerëzve që dukej se ishin duke e përballuar jetesën relativisht mirë, por nuk ishin të mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme nga valët e goditjes social-ekonomike të shkaktuar nga ajo. Ndikimet social-ekonomike të pandemisë e kanë bërë të vështirë shpërfilljen nga ana e politikëbërësve të një sërë grupeve të popullsisë - përfshirë fëmijët, të moshuarit, kujdestarët e papaguar, gratë dhe burrat që punojnë në forma të ndryshme të punësimit dhe në ekonominë informale - të cilët ishin të mbuluar në mënyrë të pamjaftueshme ose nuk ishin të mbuluar fare nga masat ekzistuese për mbrojtjen sociale. Nëpërmjet zbulimit të këtyre mangësive, ky raport dëshmon se pandemia i ka shtyrë shtetet e ndryshme drejt marrjes së veprimeve të papara ndonjëherë në rang politikash, ku mbrojtja sociale qëndron në pararojë.

***COVID-19 provokoi një reagim të pashembullt të politikave për mbrojtjen sociale.*** Qeveritë e vendeve të ndryshme e renditën mbrojtjen sociale në vijën e parë të përpjekjeve të tyre për të mbrojtur shëndetin, vendet e punës dhe të ardhurat e njerëzve dhe për të garantuar stabilitetin social. Aty ku u pa e nevojshme, qeveritë e shtrinë mbulimin tek grupet e pambrojtura deri më tani, rritën nivelet e përfitimeve ose ofruan përfitime të reja, përshtatën mekanizmat administrativë dhe ofruan, si dhe mobilizuan burime financiare shtesë. Sidoqoftë, megjithë mbështetjen ndërkombëtare, shumë vende me të ardhura të

ulëta dhe të mesme janë sforcuar për të siguruar një mbrojtje sociale proporcionale dhe një reagim stimulues për të frenuar ndikimet negative të pandemisë ashtu siç arritën ta bënin vendet me të ardhura të larta, duke çuar kështu në një "hendek të stimullit" që rrjedh kryesisht nga mungesat e konsiderueshme në aspektin e mbulimit dhe financimit.

***Rimëkëmbja social-ekonomike mbetet e pasigurt dhe shpenzimet e shtuara për mbrojtjen sociale do të vazhdojnë të jenë vendimtare.*** Parashikimet më të fundit të FMN-së paralajmërojnë një rimëkëmbje divergjente, ku vendet më të pasura do të gëzojnë një rikthim të shpejtë ekonomik ndërsa vendet me të ardhura më të ulëta do të përballen me një përmbysje të përfitimeve të tyre nga zhvillimet e fundit. Sigurimi i rimëkëmbjes me në qendër njeriun kudo varet nga qasja e barabartë tek vaksinat. Ky nuk është vetëm një detyrim moral, por edhe një domosdoshmëri e shëndetit publik: hendeku i thellë sa i takon qasjes tek vaksinat do të çojë në mutacione të reja virale që minojnë përfitimin nga vaksinat për shëndetin publik kudo. Tashmë, megjithatë, qasja e pabarabartë tek vaksinat, mangësitë shumë të mëdha sa i takon stimullit, të dukshme këto edhe në reagimin ndaj krizës, thirrjet e pakonsideruara për solidaritet global, shtimi i varfërisë dhe pabarazisë dhe përdorimi i masave shtrënguese për shkurtimin e shpenzimeve, të gjitha flasin për perspektivën e rimëkëmbjes së pabarabartë. Një skenar i tillë do të bëjë që shumë njerëz të mbahen gjallë me mjetet e tyre, si dhe do të çënojë progresin e arritur në kuadrin e Axshendës 2030 dhe realizimin e drejtësisë sociale.

***Vendet janë në udhëkryq sa i përket trajektores së sistemeve të tyre të mbrojtjes sociale.*** Nëse kjo krizë ka një anë pozitive, ajo lidhet me faktin që ka shërbyer si kujtesë e fuqishme sa i takon rëndësisë kritike të investimeve për mbrojtjen sociale; megjithatë, shumë vende përballen me kufizime të konsiderueshme fiskale. Sipas këtij raporti, pothuajse të gjitha vendet, pavarësisht nga niveli i tyre i zhvillimit, kanë mundësinë për të zgjedhur: nëse do të ndjekin strategjinë "high road" për të investuar në forcimin e sistemeve të tyre të mbrojtjes sociale për një periudhë afatgjatë apo strategjinë "low road" të ofertës minimaliste, duke iu dorëzuar presioneve fiskale ose politike. Të gjitha vendet mund të përdorin dritaren e politikave të hapur me forcë nga pandemia dhe të bazohen tek masat për reagimin ndaj krizave për të forcuar sistemet e tyre të mbrojtjes sociale dhe për të mbyllur në mënyrë graduale hendekun që ekziston në aspektin e mbrojtjes, për të

garantuar mbrojtjen e gjithësecilit nga goditjet sistematike dhe risqet e zakonshme të ciklit të jetës. Kjo do të kërkonte përpjekje më të mëdha për të ndërtuar sisteme universale, gjithëpërfshirëse, të përshtatshme dhe të qëndrueshme të mbrojtjes sociale, duke përfshirë një dysheme solide për mbrojtjen sociale që garanton të paktën një nivel bazë të sigurimeve shoqërore gjatë gjithë jetës së tyre. Alternativa do të ishte pajtimi me qasjen "low road" nëpërmjet të cilës do të ishte i pamundur investimi për mbrojtjen sociale, duke i kufizuar kështu vendet në një trajektore të llojit "kosto e ulët

-zhvillim i ulët njerëzor". Kjo do të nënkuptonte një mundësi të humbur për forcimin e sistemeve të mbrojtjes sociale dhe rikonfigurimin e shoqërive për një të ardhme më të mirë.

*Vendosja e mbrojtjes sociale universale dhe realizimi i të drejtës së njeriut për sigurim shoqëror për të gjithë është themeli i një qasjeje të përqendruar te njeriu për të arritur drejtësinë sociale.* Kjo kontribuon në parandalimin e varfërisë dhe frenimin e pabarazisë, rritjen e kapaciteteve dhe produktivitetit njerëzor, nxitjen e dinjitetit, solidaritetit dhe drejtësisë, dhe ripërtëritjen e kontratës sociale.

## ► Situata e mbrojtjes sociale: Ka patur përparim, por të pamjaftueshëm

Deri në vitin 2020, vetëm 46.9 përqind e popullsisë globale ishin të mbuluar në mënyrë efektive nga të paktën një pagesë në kuadrin e mbrojtjes sociale<sup>1</sup> (Treguesi i Objektivit për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ) 1.3.1; shiko figurën 1), ndërsa pjesa e mbetur prej 53.1 përqind - 4.1 miliardë njerëz - ishin lënë plotësisht të pambrojtur. Pas kësaj mesatare globale, qëndrojnë pabarazi të konsiderueshme të evidentuara nga rajoni në rajon dhe brenda rajoneve vetë, me norma mbulimi në Evropë dhe Azinë Qendrore (83.9 përqind) dhe në Amerikën e Veriut dhe Jugut (64.3 përqind) mbi mesataren globale, ndërsa Azia dhe Paqësori (44.1 përqind), Shtetet Arabe (40.0 përqind) dhe Afrika (17.4 përqind) shfaqin mangësi shumë më të theksuara sa i takon mbulimit.

Qasja tek kujdesi shëndetësor, pagesat në rast sëmundjeje dhe pagesat e papunësisë kanë marrë një rëndësi të veçantë gjatë periudhës së pandemisë. Ndërsa pothuajse dy të tretat e popullsisë globale mbrohen nga një lloj skeme shëndetësore, mangësitë e konsiderueshme sa i takon mbulimit dhe përshtatshmërisë vazhdojnë të ekzistojnë. Kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të ardhurave gjatë sëmundjeve dhe papunësisë, mangësitë në aspektin e mbulimit dhe përshtatshmërisë janë edhe më të theksuara. Për përafërsisht një të tretën e personave në moshë pune, sigurimi i të ardhurave mbrohet me ligj në rast sëmundjeje, dhe aktualisht më pak se një e pesta e punëtorëve të papunë në të gjithë botën marrin pagesa papunësie.

Hendeqet sa i takon mbulimit, gjithëpërfshirjes dhe përshtatshmërisë së sistemeve të mbrojtjes sociale lidhen me nëninvestimet e konsiderueshme në sektorin e mbrojtjes sociale, veçanërisht në Afrikë, Shtetet Arabe dhe në Azi. Vendet shpenzojnë mesatarisht 12.9 përqind të PBB-së së tyre për mbrojtjen sociale (pa përfshirë shëndetësinë), por kjo shifër maskon luhatje tronditëse. Vendet me të ardhura të larta shpenzojnë mesatarisht 16.4 përqind, ose dy herë më shumë se vendet me të ardhura të mesme të larta (të cilat shpenzojnë 8 përqind), gjashtë herë më shumë se vendet me të ardhura të

mesme të ulëta (2.5 përqind) dhe 15 herë më shumë se vendet me të ardhura të ulëta (1.1 përqind).


Ky hendek financimi për ndërtimin e dyshemeve të mbrojtjes sociale është zgjeruar me rreth 30 përqind që nga fillimi i krizës COVID-19, për shkak të rritjes së nevojës për shërbime të kujdesit shëndetësor, masave për sigurinë e të ardhurave dhe reduktimit të PBB-së të shkaktuara nga kriza. Për të garantuar të paktën një nivel bazë të sigurimit shoqëror përmes dyshemesë së mbrojtjes sociale të përcaktuar në shkallë kombëtare, vendet me të ardhura të ulëta-të mesme do të duhet të investojnë një shumë shtesë prej 362.9 miliardë dollarësh dhe vendet me të ardhura të mesme-të larta një shumë shtesë prej 750.8 miliardë dollarësh në vit, e barasvlershme me 5.1 dhe 3.1 përqind e PBB-së respektivisht për të dy grupet. Vendet me të ardhura të ulëta do të duhet të investojnë një shumë shtesë prej 77.9 miliardë dollarë amerikanë, e barasvlershme me 15.9 përqind të PBB-së së tyre.

COVID-19 kërcënon të rrezikojë vitet e përparimit drejt arritjes së Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ), duke përmbysur edhe arritjet për uljen e varfërisë. Ai gjithashtu ka zbuluar edhe mangësitë e mëparshme ekzistuese të mbrojtjes në të gjitha vendet dhe ka bërë të pamundur që politikëbërësit të shpërfillin deficitet e vazhdueshme të mbrojtjes sociale të përjetuara në veçanti nga grupe të caktuara, siç janë punëtorët informalë, emigrantët dhe kujdestarët e papaguar.

Kjo krizë ka sjellë një reagim të paparë por të pabarabartë të mbrojtjes sociale në nivel global. Vendet me të ardhura më të larta ndodheshin në një pozicion më të favorshëm për të mobilizuar sistemet e tyre ekzistuese ose për të aktivizuar masa të reja emergjente me qëllim frenimin e ndikimit të krizës në shëndetësi, vendet e punës dhe në të ardhura. Përgatitja e përgjigjes ndaj kësaj situatë ishte më sfiduese në kontekste me të ardhura më të ulëta, të cilat ishin mjerisht të keqpërgatitura dhe kishin më pak hapësirë për manovrim në rang politikash, veçanërisht sa i takon politikës makroekonomike.

<sup>1</sup> Duke përfshirë kujdesin shëndetësor dhe pagesën në rast sëmundjeje/ për arsye shëndetësore.

► **Figura 1. Treguesi i OZhQ 1.3.1: Mbulimi efektiv me mbrojtje sociale, vlerësimet globale dhe rajonale, sipas grupit të popullsisë, për vitin 2020 ose vitin e fundit në dispozicion**



\* Të interpretohet me kujdes: vlerësimet bazuar në mbulimin e të dhënave të raportuara nën 40% të popullsisë.

**Shënime:** Shih Shtojcën 2 të *Raportit Botëror për Mbrojtjen Sociale* për shpjegim metodologjik. Agregatet globale dhe rajonale janë peshuar sipas grupeve përkatëse të popullsisë.

**Burimet:** ILO, *Baza e të Dhënave Botërore për Mbrojtjen Sociale*, bazuar në Kërkimin për Sigurimet Shoqërore; ILOSTAT; burimet kombëtare

**Lidhja:** <https://wspr.social-protection.org>.

## ► Mbrojtja sociale për fëmijët mbetet e kufizuar, por është vendimtare për të çliruar potencialin e tyre

### Pikat kulminante

- Pjesa dërrmuese e fëmijëve nuk është ende e mbuluar në mënyrë efektive nga skemat e mbrojtjes sociale dhe vetëm 26.4 përqind e fëmijëve në nivel global marrin pagesa në kuadrin e mbrojtjes sociale. Mbulimi efektiv është veçanërisht i ulët në disa rajone: 18 përqind në Azi dhe Paqësor, 15.4 përqind në Shtetet Arabe dhe 12.6 përqind në Afrikë.
- Zhvillimet pozitive të kohëve të fundit përfshijnë miratimin e pagesës universale ose pothuajse-universale të fëmijëve në disa vende, dhe ndërgjegjësimin e ripërtërirë në kontekstin e COVID-19 për rëndësinë kritike të sistemeve gjithëpërfshirëse të mbrojtjes sociale, shërbi- meve cilësore të kujdesit për fëmijët dhe nevojën për mbrojtjen sociale të kujdestarëve.
- Mesatarisht, shpenzimet kombëtare për mbrojtjen sociale të fëmijëve janë shumë të ulëta, të barabarta me vetëm 1.1 përqind të PBB-së, krahasuar me 7 përqind të PBB-së të shpenzuar për pensionet. Rajonet e botës me përqindjen më të madhe të fëmijëve në raport me popullsinë dhe me nevojën më të madhe për mbrojtje sociale, kanë disa nga nivelet më të ulëta të mbulimit dhe shpenzimeve, veçanërisht Afrika nën-Sahariane (0.4 përqind e PBB-së).
- Për të adresuar rritjen dramatike të varfërisë së fëmijëve të shkaktuar nga COVID-19, për të mbyllur hendeqet sa i takon mbulimit me anën e mbrojtjes sociale dhe për të prodhuar rezultatet më të mira për fëmijët dhe shoqërinë, politikëbërësit duhet të zbatojnë qasjen e sistemeve të integruara duke përfshirë pagesat për fëmijët dhe shërbimet e kujdesit për fëmijët, sigurimin e lejes prindërore dhe qasjen tek kujdesi shëndetësor.

## ► Mbrojtja sociale për gratë dhe burrat në moshë pune siguron mbrojtje të pamjaftueshme kundër risqeve kryesore

### Pikat kulminante

- *Amësia*: Disa vende kanë bërë përparim bindës drejt mbulimit efektiv universal ose pothuajse-universal të amësisë. Megjithatë ndikimet pozitive në zhvillimin e mbështetjes së grave shtatzënë, vetëm 44.9 përqind e grave me fëmijë të porsalindur në mbarë botën marrin pagesën e lehonisë në para.
- *Sëmundja/ Arsyet shëndetësore*: Kriza ka demonstruar rëndësinë e garantimit të sigurisë së të ardhurave në rast sëmundjeje, përfshirë karantinën. Megjithatë, siguria e të ardhurave në rast sëmundjeje mbrohet me ligj vetëm për një të tretën e popullsisë së botës në moshë pune.
- *Aftësia e kufizuar*: Përqindja e njerëzve me aftësi të kufizuara të rënda në mbarë botën që marrin pagesa për aftësinë e kufizuar mbetet e ulët në masën 33.5 përqind. Ajo që është më e rëndësishmja ka të bëjë me faktin që tani disa vende kanë në dispozicion programet universale për pagesën e aftësisë së kufizuar.
- *Lëndimi në punë*: Vetëm 35.4 përqind e fuqisë punëtore globale kanë qasje efektive tek mbrojtja në rast lëndimi në punë. Shumë vende e kanë njohur COVID-19 si dëmtim profesional me qëllim sigurimin e qasjes më të lehtë dhe më të shpejtë tek përfitimet përkatëse në kuadrin e sistemit të sigurimit në rast lëndimi në punë, veçanërisht për punëtorët në sektorët më të ekspozuar.
- *Mbrojtja nga papunësia*: Vetëm 18.6 përqind e punëtorëve të papunë në mbarë botën janë të mbuluar në mënyrë efektive në rast papunësie, dhe si të tillë marrin edhe pagesat e papunësisë. Kjo mbetet dega më pak e zhvilluar e mbrojtjes sociale. Sidoqoftë, pandemia ka nxjerrë në pah rolin vendimtar të skemave të mbrojtjes në rast papunësie për të mbrojtur vendet e punës dhe të ardhurat, përmes skemave për ruajtjen e vendeve të punës dhe pagesave të papunësisë.
- *Vlerësimet e shpenzimeve* tregojnë se në mbarë botën vetëm 3.6 përqind e PBB-së shpenzohet për mbrojtjen sociale publike për të garantuar sigurinë e të ardhurave për personat në moshë pune.

## ► Mbrojtja sociale për gratë dhe burrat e moshuar ende përballet me sfida sa i takon mbulimit dhe përshtatshmërisë së saj

### Pikat kulminante

- Pensionet për gratë dhe burrat e moshuar janë forma më e përhapur e mbrojtjes sociale në botë, dhe një element kyç në arritjen e Objektivit për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZhQ) 1.3. Në rang global, 77.5 përqind e njerëzve mbi moshën e pensionit marrin një formë pensioni pleqërie. Megjithatë, pabarazitë kryesore nga rajoni në rajon, midis zonave rurale dhe urbane, dhe midis grave dhe burrave vazhdojnë të ekzistojnë. Shpenzimet për pensionet dhe përfitimet e tjera për të moshuarit përbëjnë mesatarisht 7.0 përqind të PBB-së, përsëri me dallime të mëdha nga rajoni në rajon.
- Përparim i konsiderueshëm është vënë re edhe sa i takon zgjerimit të mbulimit të sistemeve të pensioneve në vendet në zhvillim. Një element tjetër edhe më inkurajues lidhet me faktin që, në një gamë të gjerë vendesh, përfshirë vendet me të ardhura mesatare-të ulëta, pensionet universale janë zhvilluar si pjesë e dyshemeve kombëtare të mbrojtjes sociale.
- Kriza e shkaktuar nga COVID-19 ka gjeneruar presion të shtuar mbi kostot dhe financimin e sistemeve të pensioneve, por ndikimi në një periudhë afatgjatë do të variojë nga niveli mesatar në atë të ulët. Reagimi i madh i

vendeve ndaj krizës ka nxjerrë në pah rolin kritik që luajnë sistemet e mbrojtjes së pleqërisë, përfshirë kujdesin afatgjatë, në sigurimin e mbrojtjes së të rriturve në moshë, veçanërisht në kohë krize, dhe urgjencën për forcimin e sistemeve të kujdesit afatgjatë për të mbrojtur të drejtat e përfituesve si dhe të punonjësve të angazhuar në sektorin e kujdesit.

- Reformat e pensioneve janë dominuar nga vëmendja e përqëndruar tek qëndrueshmëria fiskale, në kurriz të parimeve të tjera të përcaktuara nga standardet ndërkombëtare të sigurimeve shoqërore, si universaliteti, përshtatshmëria dhe parashikueshmëria e përfitimeve, solidariteti dhe financimi kolektiv. Këto parime janë vendimtare për garantimin e sigurisë së të ardhurave të të moshuarve, i cili është dhe duhet të mbetet objektivi kryesor i çdo sistemi pensionesh. Sigurimi i përshtatshmërisë së përfitimeve është veçanërisht i rëndësishëm për gratë, personat në vende pune me pagesë të ulët dhe personat e angazhuar në forma të pasigurta punësimi. Përveç kësaj, shumë vende në mbarë botën janë ende duke u përpjekur për të zgjeruar dhe financuar sistemet e tyre të pensioneve; këto vende përballen me barriera strukturore të lidhura me nivelet e ulëta të zhvillimit ekonomik, nivelet e larta të informalitetit, kapacitetin e ulët kontributiv, varfërinë dhe hapësirën e pamjaftueshme fiskale, ndër të tjera.

## ► Mbrojtja e shëndetit social: Një kontribut thelbësor për mbulimin shëndetësor universal

### Pikat kulminante

- Përparim i konsiderueshëm është bërë në aspektin e rritjes së mbulimit të popullsisë, ku gati dy të tretat e popullsisë globale janë të mbrojtur në kuadrin e një skeme. Sidoqoftë, pengesat për qasjen tek kujdesi shëndetësor mbeten në formën e pagesave të drejtpërdrejta "nga xhepi" për shërbimet shëndetësore, distanca fizike, kufizimet sa i takon gamës, cilësisë dhe pranueshmërisë së shërbimeve shëndetësore, dhe orët e gjata të pritjes, si dhe kostot oportune si koha e humbur e punës. Kriza e shkaktuar nga COVID-19 ka nxjerrë në pah kufizimet sa i takon mjaftueshmërisë së përfitimeve dhe nevojën për të zvogëluar pagesat e drejtpërdrejta 'nga xhepi'.

- Financimi kolektiv, ndarja e gjerë e risqeve dhe të drejtat e bazuara në të drejta janë kushtet kryesore për të mbështetur qasjen efektive tek kujdesi shëndetësor për të gjithë duke reaguar shpejt ndaj goditjeve. Parimet e parashikuara nga standardet ndërkombëtare të sigurimeve shoqërore janë më të vlefshme se kurrë në rrugën drejt mbulimit universal të shëndetit, dhe veçanërisht në kontekstin aktual të shëndetit publik. Ajo që nevojitet tani ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave më të shumta dhe më të sakta në lidhje me mbulimin ligjor si çështje prioritare për të monitoruar përparimin në aspektin e mbulimit dhe barazisë.
- Investimi për sigurimin e shërbimeve cilësore të kujdesit shëndetësor është vendimtar.

Pandemia COVID-19 ka zbuluar më tej nevojën për të investuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe për të përmirësuar koordinimin brenda sistemit shëndetësor. Pandemia po sjell në vëmendje sfidat me të cilat përballet procesi i rekrutimit, sistemimit në punë, ruajtjes dhe mbrojtjes së punonjësve të trajnuar dhe të motivuar të sektorit shëndetësor për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore të kujdesit shëndetësor.

- Për të adresuar përcaktuesit kryesorë të shëndetit në mënyrë më efektive, nevojitet vendosja e lidhjeve më të forta dhe koordinim më i mirë midis mekanizmave për qasjen tek kujdesi

mjekësor dhe siguria e të ardhurave. Kriza e shkaktuar nga COVID-19 ka theksuar më tej rolin e sistemit të mbrojtjes sociale në formësimin e sjelljeve për të nxitur parandalimin dhe komplementaritetin e skemave të përfitimeve për kujdesin shëndetësor dhe në rast sëmundjesh. Qasjet e koordinuara janë veçanërisht të nevojshme sa i takon nevojave të veçanta dhe në zhvillim, duke përfshirë lëvizshmërinë e njerëzve, barrën në rritje të sëmundjeve të gjata dhe kronike dhe plakjen e popullsisë. Ndikimi i COVID-19 tek personat e moshuar ka hedhur edhe më shumë dritë mbi nevojën për koordinimin e punës midis kujdesit shëndetësor dhe atij social.

## ► Zgjedhja afatgjatë "*high road*" drejt mbrojtjes sociale universale për një të ardhme të barabartë në aspektin shoqëror

COVID-19 ka theksuar edhe më tepër rëndësinë kritike të mbrojtjes sociale universale. Është thelbësore që tani vendet e ndryshme - qeveritë, partnerët socialë dhe palët e tjera të interesit - t'i rezistojnë presioneve për tu kthyer prapa dhe për të rënë në trajektoren minimaliste "*low road*", si dhe të ndjekin strategjinë afatgjatë "*high road*" për mbrojtjen sociale për tu përballur me pandeminë në vazhdim dhe për të siguruar rimëkëmbjen e përqendruar tek faktori njerëzor dhe një të ardhme gjithëpërfshirëse. Për këtë qëllim, përparësitë e identifikuar janë si më poshtë.

- Masat e marra për garantimin e mbrojtjes sociale gjatë periudhës së COVID-19 duhet të vazhdojnë të zbatohen derisa të zbutet kriza dhe rimëkëmbja të jetë në rrugë të mbarë. Kjo do të kërkojë investime të vazhdueshme në sistemet e mbrojtjes sociale për të ruajtur standardet e jetesës, për të garantuar qasje të barabartë tek vaksina dhe kujdesi shëndetësor dhe për të parandaluar tkurrjet e mëtejshme ekonomike. Garantimi i qasjes së barabartë dhe në kohë tek mundësia e vaksinimit është vendimtar për shëndetin dhe prosperitetin e të gjitha vendeve dhe popujve. Në një botë të ndërlidhur, rimëkëmbja e vërtetë gjithëpërfshirëse varet pikërisht nga kjo.
- Tundimi për t'u rikthyer tek konsolidimi fiskal për të paguar shpenzimet masive publike të diktuar nga COVID-19 duhet shmangur. Krizat e mëparshme kanë treguar se masat shtrënguese lënë plagë të thella shoqërore, duke dëmtuar personat më vulnerabel në shoqëri. Anasjelltas,

përpjekja për një rimëkëmbje të pasur me vende pune, të përqendruar tek njeriu, në harmoni me qëllimet shëndetësore, sociale, mjedisore dhe ndryshimet klimatike, mund të kontribuojë në sigurinë e të ardhurave, krijimin e vendeve të punës dhe objektivat e kohezionit social, të zgjerojë bazën tatimore dhe të ndihmojë në financimin e mbrojtjes universale sociale.

- Në mes të rrënimit të shkaktuar nga pandemia, disa dritëza shprese na bëjnë të mendojmë që edhe mendësia ka ndryshuar. Duke ekspozuar cënueshmërinë e natyrshme të të gjithëve - duke e bërë të qartë se mirëqenia jonë individuale është e lidhur ngushtë me mirëqenien kolektive dhe sigurinë e të tjerëve - pandemia ka demonstruar domosdoshmërinë e mbrojtjes sociale. Për më tepër, kriza ka treguar se vendet kanë hapësirë të konsiderueshme për të përqafuar mendësinë "çfarëdo lloj gjëje që duhet" për të arritur qëllimet prioritare nëse e dëshirojnë një gjë të tillë. Nëse zbatohet e njëjta qasje politike ndërkohë që kalon më e keqja e pandemisë, atëherë do të mbahet premtimi për të shkuar me zgjedhjen afatgjatë "*high road*" për të arritur Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZhQ) dhe mbrojtjen universale sociale.
- Zgjedhja "*high road*" kërkon ndërtimin e sistemeve të përhershme të mbrojtjes shoqërore universale që ofrojnë mbulim të mjaftueshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë, të udhëhequr nga dialogu social efektiv në nivel trepalësh.



Këto sisteme janë thelbësore për parandalimin e varfërisë dhe pabarazisë, dhe për adresimin e sfidave të sotme dhe të së nesërme, në veçanti duke promovuar punën e denjë, duke mbështetur gratë dhe burrat për të përballuar sa më mirë tranzicionin e tyre në jetë dhe në punë, duke lehtësuar kalimin e punëtorëve dhe ndërmarrjeve nga ekonomia informale në ekonominë formale, duke forcuar transformimin strukturor të ekonomive dhe duke mbështetur kalimin drejt ekonomive dhe shoqërive më të qëndrueshme në aspektin mjedisor.

- ▶ Tani, për plotësimin e hendeqeve financiare nevojitet kryerja e investimeve të mëtejshme për mbrojtjen sociale. Në veçanti, prioritizimi i investimeve në nivelet e mbrojtjes sociale të përcaktuara në shkallë kombëtare është jetik për të përmbushur premtimin në kuadrin e Axhendës 2030. Hapësira fiskale ekziston edhe në vendet më të varfra dhe mobilizimi i burimeve të brendshme është faktor kyç, por edhe mbështetja e bashkërenduar ndërkombëtare është po aq vendimtare për të garantuar përparimin e shpejtë në ato vende që nuk kanë kapacitete fiskale dhe ekonomike, veçanërisht në vendet me të ardhura të ulëta me nëninvestim të theksuar në sistemin e mbrojtjes sociale.
- ▶ Mbrojtja sociale universale mbështetet përmes përpjekjeve të përbashkëta të agjencive të Kombeve të Bashkuara "që punojnë si një trup i vetëm", dhe përmes përpjekjeve të bashkërenduara me institucionet përkatëse ndërkombëtare, rajonale, nënrajonale dhe kombëtare dhe partnerët socialë, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar, përfshirë edhe përmes Partneritetit Global për Mbrojtjen Sociale Universale.
- ▶ Dritarja unike e politikave e hapur me forcë nga COVID-19 duhet t'i inkurajojë vendet që të ndërmarrin menjëherë veprime vendimtare për të ardhmen e mbrojtjes sociale dhe të ndjekin me vull qasjen e politikave afatgjata "*high road*". Kjo do t'i fuqizonte shoqëritë për të përballuar krizat e ardhshme dhe sfidat e paraqitura nga ndryshimi demografik, bota në zhvillim e punës, migracioni, sfidat mjedisore dhe kërcënimi ekzistencial i ndryshimit klimatik. Në fund të fundit, një sistem i fuqishëm i mbrojtjes sociale do të mbështesë dhe do të riparojë kontratën e brishtë shoqërore dhe do t'u krijojë mundësinë vendeve për të gëzuar një të ardhme sa më të barabartë në aspektin shoqëror.

# 2 Mbrojtja sociale në udhëkryq në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Azinë Qendrore

Në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe të Azisë Qendrore janë krijuar tashmë sistemet gjithëpërfshirëse për mbrojtjen sociale, nëse krahasohen me mesataret botërore dhe rajonet e tjera. Sidoqoftë, fushëveprimi dhe modeli i këtyre sistemeve në të gjithë rajonin janë të ndryshme. Në vendet e Azisë Qendrore dhe Kaukazit, këto ndryshime janë më të theksuara si rezultat i kalimit të tejzgatur nga ekonomitë socialiste/ komanduese në ekonomitë e tregut si dhe presionet fiskale të dy dekadave të fundit. Në shumë raste, këto programe janë konsumuar gradualisht ose janë ndërprerë, shoqëruar me rikonfigurimin e burimeve të financimit dhe pakësimin e investimeve, duke çuar kështu në mungesa sa i takon mbulimit ligjor dhe efektiv, dhe në zvogëlimin e përshtatshmërisë. Sidoqoftë, ratifikimi i standardeve ndërkombëtare për sigurimet shoqërore, veçanërisht i Konventës së ILO-s për Sigurimet Shoqërore (Standardet Minimale), 1952 (Nr. 102), është ndjekur në mënyrë aktive nga disa nga vendet e rajonit.<sup>2</sup> Kjo mund të shihet si një shenjë pozitive e angazhimit të vendeve në fjalë për të garantuar nivelet minimale të

mbrojtjes, përfshirë përcaktimin e dyshemeve të mbrojtjes sociale. Sidoqoftë, në kushtet e sëmundjes së koronavirusit (COVID-19) dhe ndryshimeve aktuale transformuese në botën e punës, ekziston nevoja për përparim e mëtejshëm sa i takon zgjerimit të shkallës së mbulimit dhe përmirësimit të përshtatshmërisë dhe mjaftueshmërisë së përfitimeve, duke garantuar edhe qëndrueshmërinë e tyre financiare afatgjatë.

Bazuar në analizën e paraqitur në botimin e fundit të *Raportit kryesor Botëror për Mbrojtjen Sociale* (ILO 2021a), ky raport shoqëruar rajonal shqyrton më nga afër aspektin e mbulimit me anën e skemave të mbrojtjes sociale në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Azisë Qendrore, duke u fokusuar tek garancitë e përzgjedhura (pensionet, pagesat e papunësisë, ndihma sociale dhe pagesat për fëmijët), dhe tek nevoja e vazhdueshme për mbrojtje sociale për t'iu përgjigjur sfidave të krijuara nga kriza COVID-19, si dhe problemet e qenësishme të nxjerra në pah nga kriza që kërkojnë zgjidhje afatgjata.

<sup>2</sup> Që nga viti 2010, Konventa Nr. 102 është ratifikuar nga Ukraina (2016) dhe Federata Ruse (2019), dhe Konventa për Mbrojtjen e Amësisë, 2000 (Nr. 183), nga Azerbajxhani (2010), Bosnja dhe Hercegovina (2010), Kazakistani (2012), Mali i Zi (2012), Maqedonia e Veriut (2012) - e njohur në atë kohë si ish Republika Jugosllave e Maqedonisë - dhe Serbia (2010).


# 3 Mbulimi i mbrojtjes sociale: Trendet dhe perspektiva rajonale

Pabarazitë midis vendeve të rajonit në lidhje me trendet dhe perspektivat e zhvillimit të sistemeve të mbrojtjes sociale janë të konsiderueshme. Figura 2 paraqet normat efektive të mbulimit për popullsinë në total të mbuluar nga degë të ndryshme të mbrojtjes sociale, ku vihen re ndryshime të konsiderueshme midis nënrajoneve, duke filluar nga mbulimi universal ose pothuajse-universal i personave të moshuar në të gjithë rajonin deri te ndryshimet e konsiderueshme sa i takon mbulimit të personave në moshë aktive dhe fëmijëve.

Të gjitha vendet në rajon kanë arritur mbulim pothuajse-universal për të moshuarit me pensione kontributive ose jo kontributive. Ky është një element kyç i sistemeve të mbrojtjes sociale i cili vazhdon të ruhet dhe që ka përballuar një sërë reformash të llojeve të ndryshme të zbatuara gjatë

tre dekadave të fundit. Mbulimi i nënave dhe të porsalindurve në Evropën Veriore, Jugore dhe Perëndimore është pothuajse-universal, por në Azinë Qendrore dhe Perëndimore ky mbulim ofrohet për pak më shumë se gjysmën e popullsisë. Niveli më i ulët i mbulimit të të papunëve është vërejtur në Azinë Qendrore dhe Perëndimore, në masën 14.7 përqind, duke u renditur shumë më poshtë sesa mesatarja botërore. Programet e ndihmës sociale për grupet më të cënueshme mbulojnë tre të katërtat e popullsisë në Evropën Veriore, Jugore dhe Perëndimore krahasuar me 42.8 përqind në Azinë Qendrore dhe Perëndimore. Ndryshimet sa i takon mbulimit të fëmijëve janë shumë të theksuara, duke filluar nga nivele pothuajse-universale në Evropën Veriore, Jugore, Perëndimore dhe Lindore deri në më pak se gjysma në Azinë Qendrore dhe Perëndimore.

► Figura 2. Treguesi i OZhQ 1.3.1: Mbulimi efektiv me mbrojtje sociale, vlerësimet rajonale dhe nënrajonale, sipas grupit të popullsisë, për vitin 2020 ose për vitin e fundit në dispozicion



**Shënime:** Shih Shtojcën 2 të [Raportit Botëror për Mbrojtjen Sociale](#) për shpjegim metodologjik. Agregatat globale dhe rajonale peshohen sipas grupeve përkatëse të popullsisë. NS = ndihma sociale; MS = mbrojtje sociale.


**Burimet:** ILO, [Baza Botërore e të Dhënave për Mbrojtjen Sociale](#), bazuar në Kërkimin për Sigurimet Shoqërore; ILOSTAT; burimet kombëtare.

**Lidhja:** <https://wspr.social-protection.org>.

Aktualisht, **pensionet e pleqërisë** mbulojnë një pjesë të madhe të të moshuarve në rajon, kryesisht përmes skemave të pensioneve kontributive të plotësuar me skema jo kontributive (figura 3). Nga të gjitha transfertat shoqërore, pagesat e pensioneve luajnë rolin më të rëndësishëm në uljen e varfërisë, veçanërisht në mesin e të moshuarve, shumica e të cilëve varen nga pensionet si burimi i vetëm i të ardhurave të tyre. Ndërsa roli parësor i pensioneve është parandalimi i varfërisë në moshën e pleqërisë, ato kanë një ndikim të konsideru-

eshëm edhe në parandalimin e varfërisë për grupet e tjera të popullsisë, përfshirë fëmijët.<sup>3</sup> Megjithatë, në shumicën e vendeve të rajonit, fondet e pensioneve përballen me sfida serioze financiare; në shumë vende, nivelet e kontributeve të pamjaftueshme për të përmbushur detyrimet e tyre kanë bërë që sistemet e pensioneve të varen gjithnjë e më shumë nga buxheti i shtetit për të mbuluar deficitet e tyre (duke filluar nga 1 përqind deri në 5 përqind të PBB-së).<sup>4</sup>

► Figura 3. Mbulimi efektiv për mbrojtjen e personave në moshën e pleqërisë: Përqindja e popullsisë në moshë pune mbi 15 vjeç e mbuluar nga skemat e pensioneve, sipas statusit të forcës së punës, sipas rajonit, nënrajonit dhe gjinisë, viti 2020 ose viti më i fundit në dispozicion



**Shënime:** Shih Shtojcën 2 të *Raportit Botëror për Mbrojtjen Sociale* për shpjegim metodologjik. AQ = Azia Qendrore; EQL = Evropa Qendrore dhe Lindore; EL = Evropa Lindore; ZETL = Zona Evropiane e Tregtisë së Lirë. BE = Bashkimi Evropian; BE e re = vendet që janë bërë Shtete Anëtare të BE-së nga viti 2004 e tutje.

**Burimet:** ILO, *Baza Botërore e të Dhënave për Mbrojtjen Sociale*, bazuar në Kërkimin për Sigurimet Shoqërore; ILOSTAT; burimet kombëtare.

**Lidhja:** <https://wspr.social-protection.org>.

<sup>3</sup> Për shembull, në Uzbekistan, sistemi i përfitimeve për fëmijët i synuar për familjet me të ardhura të ulëta është përgjegjës për vetëm 12 përqind të uljes së përgjithshme të shkallës së varfërisë së fëmijëve, ndërsa rreth 70 përqind mund t'i atribuohet programeve të pensioneve (UNICEF 2019).


<sup>4</sup> Në Bosnje dhe Hercegovinë, fondet e pensioneve të njëjsteve të saj janë transferuar në buxhetin e përgjithshëm qeveritar përkatës. Në Ukrainë, qeveria është duke përgatitur një projektligj i cili parashikon zbatimin e një niveli pensional me financim të detyruar.

### ► 3.1. Mbrojtja e popullsisë në moshë pune: Mesi i munguar në rritje

Ndërsa mbulimi efektiv me pensione i të moshuarve është relativisht i lartë në masën 96.7 përqind të popullsisë së rajonit të moshës 65 vjeç e sipër, në shumë vende në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Azinë Qendrore, popullsia në moshë pune është e mbrojtur në mënyrë të pamjaftueshme (shiko figurat 4 dhe 5). Arsyet kryesore për nivelet e

ulëta të mbulimit janë pjesëmarrja relativisht e ulët e fuqisë punëtore dhe papunësia e lartë (veçanërisht për të rinjtë dhe gratë), së bashku me informilitetin shumë të përhapur dhe punën e padeklaruar, veçanërisht me nën-raportimin e pagave; të gjithë këta faktorë paraqesin sfida serioze për rritjen e mbulimit me sigurime shoqërore.

► Figura 4. Mbulimi efektiv për mbrojtjen e personave në moshën e pleqërisë: Përqindja e popullsisë në moshë pune mbi 15 vjeç e mbuluar nga skemat e pensioneve, sipas statusit të forcës së punës dhe gjinisë, vendet e zgjedhura, viti 2020 ose viti më i fundit në dispozicion



**Shënim:** Shikoni Shtojcën 2 të *Raportit Botëror për Mbrojtjen Sociale* për shpjegim metodologjik.

SHQ = Shqipëria; BeH = Bosnja dhe Hercegovina; RMD = Republika e Moldavisë; MiZ = Mali i Zi; SRB = Serbia; UKR = Ukraina; ARM = Armenia; AZE = Azerbajxhani; BJELL = Bjellorusia; GJEO = Georgia; KAZ = Kazakistani; FRUS = Federata Ruse; TXHK = Taxhikistani.


**Burimet:** ILO, *Baza Botërore e të Dhënave për Mbrojtjen Sociale*, bazuar në Kërkimin për Sigurimet Shoqërore; ILOSTAT; burimet kombëtare.

Rajoni ka përjetuar një diversifikim në rritje sa i takon modaliteteve të punësimit, me një rënie të punësimit "standard" (domethënë, punë me kohë të plotë dhe me kohëzgjatje të pacaktuar, që përfshin një marrëdhënie pune midis një punonjësi dhe një punëdhënësi), dhe një numër në rritje të punëtorëve në forma "jo standarde" të punësimit, përfshirë punësimin e përkohshëm (me afat të caktuar) dhe të rastësishëm, punën me kohë të pjesshme dhe punën "në gatishmëri", punësimin e përkohshëm nëpërmjet agjencive përkatëse dhe marrëdhëniet e punës të maskuara si vetëpunësim. Një zhvillim i rëndësishëm i kohëve të fundit ka të bëjë me rritjen e punës së ndërmjetësuar nga platformat dixhitale, duke përfshirë punën e ofruar në nivel lokal dhe punën me grupe të mëdha punonjësish (*crowdworking*) (ILO 2021b). Nivelet e ulëta aktuale të mbulimit kontributiv ngrenë shqetësime të konsiderueshme jo vetëm në lidhje me mangësitë financiare aktuale, por edhe me mbulimin e përfituesve të ardhshëm. Në planin afatgjatë, nivelet vazhdimisht të ulëta të kontributeve do të përkthehen në nivele më të ulëta

përfitimesh dhe në një përkeqësim të mbulimit të sistemit të pensioneve kontributive. Kjo mund të zhvendosë tek ndihma sociale barrën e financimit të sigurisë së të ardhurave për të moshuarit që gëzojnë të drejta të ulëta ose që nuk e gëzojnë aspak të drejtën e pensionit.

Diversifikimi i modaliteteve të punësimit dhe skemat e munguara ose të pafinancuara për sigurimin kundër papunësisë kanë ndikuar edhe në mbulimin e popullsisë në moshë pune në lidhje me **pagesat e papunësisë** (figura 5). Papunësia afatgjatë dhe nivelet e larta të punësimit informal, shoqëruar me nivelet e ulëta të përfitimeve (në ato vende ku ekzistojnë përfitime të tilla), janë përkthyer historikisht në regjistrim të kufizuar të punëtorëve të papunë, me një numër edhe më të vogël të përfituesve nga pagesat e papunësisë. Në vendet e Azisë Qendrore dhe Kaukazit, vetëm 5.7 përqind dhe 6.6 përqind e personave të papunë, përkatësisht, marrin pagesat e papunësisë, krahasuar me 67.1 përqind në Evropën Lindore dhe 96.5 përqind në Evropën Perëndimore. Këto nivele janë shumë më të ulëta se mesatarja globale prej 18.6 përqind.

► Figura 5. Treguesi i OZhQ 1.3.1 për mbulimin efektiv për mbrojtjen kundër papunësisë: Përqindja e personave të papunë që marrin përfitime në para, sipas rajonit, nënrajonit dhe nivelit të të ardhurave, viti 2020 ose viti më i fundit në dispozicion



**Shënim:** Shikoni Shtojcën 2 të *Raportit Botëror për Mbrojtjen Sociale* për shpjegim metodologjik. Azia Perëndimore përfshin Armeninë, Azerbajxhanin, Qipron, Gjeorgjinë, Izraelin dhe Turqinë. Për qëllimet e këtij raporti, vendet e Kaukazit përfshijnë Armeninë, Azerbajxhanin dhe Gjeorgjinë.

**Burimet:** ILO, *Baza Botërore e të Dhënave për Mbrojtjen Sociale*, bazuar në Kërkimin për Sigurimet Shoqërore; ILOSTAT; burimet kombëtare.


**Lidhja:** <https://wspr.social-protection.org>.

Për shembull, në vitin 2019 Uzbekistani regjistroi 1.34 milionë persona të papunë, megjithëse, sipas vlerësimeve, për të plotësuar kërkesën nevojiten 4 milionë vende pune në vit. Nga një përqindje tashmë e ulët e të papunëve të regjistruar, vetëm 57,900 merrnin pagesa papunësie, sipas burimeve kombëtare të të dhënave.<sup>5</sup> Në Gjeorgji dhe Armeni sigurimi kundër papunësisë dhe pagesat e papunësisë janë hequr, përkatësisht në vitin 2006 dhe 2015. Në përpjekje për të zbutur ndikimin e COVID-19 tek punëtorët që humbën punën si rezultat i pandemisë, disa vende kanë lehtësuar kriteret e pranimit për pagesat e papunësisë (për shembull Kirgistani), kanë rritur nivelin e përfitimit (për shembull Azerbajxhani dhe Uzbekistani) ose kanë filluar ta zbatojnë atë si një masë të përkohshme (Gjeorgji). Në përgjithësi, ndikimi i pandemisë ka rritur interesin për mbrojtjen e punëtorëve si dhe ndërgjegjësimin në lidhje me faktin se programet ekzistuese të ndihmës sociale dhe vetëpunësimit që ishin të destinuara në mënyrë implicite për

të kontribuar në sigurimin e të ardhurave të personave të papunë nuk i plotësonin këto pritshmëri.

Në shumicën e rajoneve, **programet e ndihmës sociale** vazhdojnë të shoqërohen kryesisht me rrejtat "e mbetura" të sigurisë të financuara nga taksat për më të varfërit, duke nënkuptuar pagesat afatshkurtra për një grup të kufizuar përfituesish. Perceptimi se ndihma sociale përkthehet në "varësi", e shoqëruar edhe me presionet për shkurtrimin e shpenzimeve të përgjithshme publike, kanë bërë që puna të përqendrohet në trajtimin e gabimeve dhe mashtrimin sa i takohen përfshirjes, në vend të gjetjes së mënyrave më proaktive për të përfshirë dhe për të garantuar mbulimin e personave në rrezik përjashtimi (shih kutinë 2 më poshtë; shih edhe UNICEF 2015, kap. 3). Këto zhvillime reflektohen edhe në ndryshimet e masës së mbulimit të popullatave të cënueshme përmes ndihmës sociale, duke filluar nga 95.8 përqind në Evropën Perëndimore, 45.4 përqind në Evropën Jugore deri në 30.7 përqind në Azinë Qendrore (figura 6).

► Figura 6. Treguesi i OZhQ 1.3.1 në lidhje me mbulimin efektiv të grupeve të cënueshme të popullsisë: Përqindja e popullsisë së cënueshme që merr ndihmë sociale, sipas rajonit dhe nënrajonit, viti 2020 ose viti më i fundit në dispozicion



**Shënim:** Shikoni Shtojcën 2 të *Raportit Botëror për Mbrojtjen Sociale* për shpjegim metodologjik. Azia Perëndimore përfshin Armeninë, Azerbajxhanin, Qipron, Gjeorgjinë, Izraelin dhe Turqinë.

**Burimet:** ILO, *Baza Botërore e të Dhënave për Mbrojtjen Sociale*, bazuar në Kërkimin për Sigurimet Shoqërore; ILOSTAT; burimet kombëtare.

**Lidhja:** <https://wspr.social-protection.org>.

<sup>5</sup> Në lidhje me alternativat e mundshme për zgjerimin e mbulimit me programe për mbrojtjen kundër papunësisë në Uzbekistan, shihni ILO 2020a; ILO, UNICEF dhe Banka Botërore 2020.




## ► 3.2. Mbrojtja e fëmijëve dhe mbështetja e familjeve

Sipas UNICEF (2020), në më shumë se gjysmën e vendeve të Evropës dhe Azisë Qendrore, mbi një e katërta e fëmijëve jetojnë nën kufijtë e varfërisë në nivel kombëtar. Familjet me tre ose më shumë fëmijë janë dukshëm më të rrezikuara nga varfëria sesa popullsia në tërësi, siç janë fëmijët që jetojnë në familje pa asnjë anëtar në punësim formal; familjet migrante, prindërit e vetëm dhe familjet e mëdha

janë të mbipërfaqësuar në decilet më të varfra (UNICEF 2014). Ndërsa Evropa Perëndimore, Lindore dhe Veriore ka arritur mbulim pothuajse-universal ose universal të fëmijëve me përfitime, në vendet e Azisë Qendrore është mbuluar vetëm një e treta dhe në vendet e Kaukazit një e katërta e fëmijëve - kjo e fundit nën mesataren botërore (figura 7).

- Figura 7. Treguesi i OZhQ 1.3.1 për mbulimin efektiv për fëmijët dhe familjet: Përqindja e fëmijëve të moshës 0-14 vjeç që marrin përfitime në para për fëmijët ose familjen, sipas rajonit, nënrajonit dhe nivelit të të ardhurave, viti 2020 ose viti më i fundit në dispozicion



**Shënime:** Shih Shtojcën 2 të *Raportit Botëror për Mbrojtjen Sociale* për shpjegim metodologjik. Azia Perëndimore përfshin Armeninë, Azerbajxhanin, Qipron, Gjeorgjinë, Izraelin dhe Turqinë. Për qëllimet e këtij raporti, vendet e Kaukazit përfshijnë Armeninë, Azerbajxhanin dhe Gjeorgjinë.

**Burimet:** ILO, *Baza Botërore e të Dhënave për Mbrojtjen Sociale*, bazuar në Kërkimin për Sigurimet Shoqërore; ILOSTAT; burimet kombëtare

**Lidhja:** <https://wspr.social-protection.org>.

Mbizotërimi në rritje i formave jo standarde të punësimit, të ardhurat e pamjaftueshme dhe qasja e kufizuar tek mbrojtja sociale janë duke krijuar edhe më shumë vështirësi për familjet sa i takon mbrojtjes së fëmijëve nga varfëria. Kjo i bën përfitimet e fëmijëve edhe më të rëndësishme për mbështetjen e mirëqenies së tyre; dhe me të vërtetë, shumica e vendeve në Evropën Qendrore dhe Lindore - me përjashtim të dukshëm të Shqipërisë - kanë zbatuar një formë apo një tjetër të paketës së përfitimeve për fëmijët. Sidoqoftë, modeli dhe struktura e tyre ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Në një numër Shtetesh Anëtare të BE-së në Evropën Qendrore dhe Lindore, dhe në Kaukaz dhe Azinë Qendrore, vetëm familjet me të ardhura nën pagën mesatare kanë të drejtë të përfitojnë pagesa në para për fëmijët, dhe nivelet e përfitimeve janë dukshëm më të ulëta se në Shtetet Anëtare të BE-së të Evropës Perëndimore (Bradshaw dhe Hirose, 2016).

Mbulimi i grave sa i takon mbrojtjes sociale në rajon vazhdon të jetë dukshëm më i ulët sesa për burrat, një mospërputhje që reflekton në masë të madhe përqindjet e tyre më të ulëta të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, dhe nivelet më të larta të punës me kohë të pjesshme dhe të përkohshme dhe punësimit informal (veçanërisht vetëpunësimit informal), hendekun gjinor në paga dhe përqindjen disproporcionalisht të lartë të punës përkujdesëse të papaguar, të cilën strategjitë kombëtare të mbrojtjes sociale shpesh nuk arrijnë ta njohin. Këta faktorë shoqërohen me modele të vazhdueshme të pabarazisë, diskriminimit dhe disavantazheve strukturore. Përmirësimi i mbrojtjes sociale për gratë mbetet një qëllim parësor i punës në këtë fushë. Për shembull, sipas vlerësimeve të ILO-s, vetëm 30.6 përqind e popullsisë në moshë pune në botë është e mbuluar ligjërisht nga sistemet gjithëpërfshirëse të sigurimeve shoqërore që përfshijnë gamën e plotë të përfitimeve, nga përfitimet për fëmijët dhe familjen deri tek pensionet e pleqërisë, ku gratë mbeten prapa meshkujve me një diferencë shumë të madhe prej 8 pikë përqindjeje. Në Evropë dhe Azinë Qendrore në tërësi, ky ndryshim është pak më i ulët se mesatarja globale, ku gratë kanë mbetur 5.3 pikë përqindje

prapa; në rajonin më të gjerë, 55 përqind e burrave në moshë pune dhe 49.7 përqind e grave në moshë pune mbulohen sipas ligjit nga sistemet gjithëpërfshirëse të sigurimeve shoqërore (ILO 2021a).

Në shumicën e vendeve në Azinë Qendrore, Kaukaz dhe në Evropën Jugore, politikat e fokusuara tek fëmijët bazohen kryesisht në logjikën e shënjestrimit të varfërisë, duke lënë shumë fëmijë të pambrojtur pa mbulim. Për shembull, burimet kombëtare të të dhënave theksojnë se në vitin 2019 rreth 51.7 përqind e fëmijëve në Armeni jetonin nën kufirin e sipërm kombëtar të varfërisë dhe mund të konsideroheshin "të varfër", krahasuar me 42.3 përqind të personave në moshë pune. Armenia është përpjekur të ulë varfërinë duke i fokusuar burimet e mbrojtjes sociale tek fëmijët më të varfër dhe më të cënueshëm (ILO dhe UN Women, së shpejti).

Sidoqoftë, të dhënat globale sugjerojnë që skemat e gjera gjithëpërfshirëse për të gjithë ciklin e jetës janë më efektive për uljen e varfërisë sesa programet që synojnë ngushtësisht luftën "kundër varfërisë". Për shembull, në Gjeorgji, pensionet e pleqërisë kanë qenë përgjegjëse për gati 70 përqind të reduktimit të përgjithshëm të varfërisë së fëmijëve prej 29 përqind të arritur përmes transfertave sociale, ndërsa programi më i rëndësishëm i synuar për Ndhimën Sociale ka ndikuar vetëm në 20 përqind të reduktimit (Kidd dhe Gelders 2015). Kjo ndodh sepse skemat më të gjera prekin shumë më tepër njerëz në mënyrë indirekte sesa ndihma sociale që synon uljen e varfërisë. Ky fenomen mund të vërehet edhe në Armeni, ku më shumë se 40 përqind e fëmijëve jetojnë me një përfitues të pensionit të pleqërisë ose të aftësisë së kufizuar. Tendencat e ngjashme vërehen edhe në Uzbekistan.

Në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, përmirësimi i sistemeve të përfitimeve të fëmijëve do të kërkonte burime të barabarta me 1–2 përqind të PBB-së. Megjithatë, gjatë viteve të fundit shumica e këtyre vendeve nuk kanë bërë asnjë rritje të konsiderueshme të shpenzimeve për mbrojtjen sociale të familjeve me fëmijë.

### ► 3.3. Mbrojtja e shëndetit social

Skema e **mbrojtjes së shëndetit social** në rajon mbulon shumicën e popullsisë kryesisht përmes kombinimit të përfitimeve kontributive dhe të financuara nga taksat, ku këto të fundit mbulojnë grupe të caktuara të popullsisë ekonomisht joaktive, siç janë personat e varur nga anëtarët e tjerë të familjes, përfituesit e ndihmës sociale dhe të papunët e regjistruar. Megjithëse shumica e vendeve kanë arritur mbulimin shëndetësor të mbi 80 përqind të popullsisë, në disa vende (për shembull, në Shqipëri, Armeni, Kirgistan dhe Ukrainë)

njerëzit duhet të bëjnë pagesa të shumta nga xhepi, përfshirë pagesat informale. Në këto vende, shumata totale e pagesave të tilla tejkalon shpenzimet për shëndetësinë të financuara nga burimet publike. Pagesat direkte nga xhepi janë një burim vështirësish financiare dhe pengesa kryesore për qasjen tek kujdesi shëndetësor, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta. (Shembullin që ilustron një përpjekje për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi e gjeni në kutinë 1).

#### ► Kutia 1. Reforma e kujdesit shëndetësor në Ukrainë

Në vitin 2016, Ukraina nisi zbatimin e një reforme për transformimin e kujdesit shëndetësor, pas ndërgjegjësimit në lidhje me shpenzimet e pamjaftueshme publike për shëndetësinë, shpërndarjen joefikase dhe të pabarabartë të burimeve publike, dhe përhapjen e praktikës së pagesave informale për kujdesin shëndetësor. Si rezultat, sistemi i kujdesit shëndetësor bazohej gjerësisht tek pagesat direkte nga xhepi, të cilat krijuan vështirësi financiare dhe pengesa për qasjen tek shërbimet e kujdesit, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta.

Reforma synonte të transformonte mekanizmin e financimit të kujdesit shëndetësor pa futur në përdorim burime të reja financimi, si bashkë-pagesat e përdoruesve apo kontributet e sigurimeve shëndetësore shoqërore.

Një element qendror i reformës është prezantimi i një pakete me përfitime për kujdesin shëndetësor të përcaktuara qartë dhe të garantuara për të gjithë nga qeveria. Paketa e garantuar nga qeveria i jep përparësi kujdesit parësor, por përfshin edhe kujdesin në raste urgjencash, kujdesin ambulator, spitalor dhe paliativ, si dhe rehabilitimin, kujdesin shëndetësor për fëmijët deri në 16 vjeç, kujdesin shëndetësor në lidhje me shtatzëninë dhe lindjen e fëmijës, ilaçet e autorizuara nga mjeku dhe produktet mjekësore bazë për trajtim spitalor. Kjo pritë të zvogëlojë pagesat direkte nga xhepi dhe të eliminojë pagesat informale.

Për të financuar paketën e përfitimeve të kujdesit shëndetësor të garantuar nga qeveria, në vitin 2018 u krijua Shërbimi Shëndetësor Kombëtar i Ukrainës (ShShKU) si një agjenci qendrore e qeverisë për të shërbyer si blerësi i vetëm kombëtar i paketës së përfitimeve të garantuara të kujdesit shëndetësor. ShShKU do të lidhë kontrata me ofruesit autonomë të kujdesit shëndetësor për t'i rimbursuar në bazë të shërbimeve mjekësore që u ofrojnë pacientëve (parimi "paratë ndjekin pacientin").

Përveç reformimit të mënyrës së financimit të kujdesit shëndetësor, qeveria është duke zbatuar edhe disa reforma thelbësore në sistemin shëndetësor kombëtar, duke përfshirë (1) ristrukturimin e rrjetit spitalor, (2) futjen në përdorim të sistemit *e-Health* për të përpunuar të gjitha të dhënat dhe informacionin mjekësor në mënyrë elektronike, dhe (3) miratimin e politikave dhe programeve të reja në fushën farmaceutike.

Suksesi i reformës varet nga fakti nëse qeveria mundet të sigurojë burime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për kujdesin shëndetësor dhe t'i ndajë ato në mënyrë efikase. Realizimi i plotë dhe i suksesshëm i reformës aktuale do të shërbejë si një bazë e fortë për përmirësime të tjera në cilësinë e kujdesit të ofruar në sistemin e kujdesit shëndetësor Ukrainas.

**Burimi:** Hirose 2019.

Si përfundim, shumica e vendeve të Evropës Veriore, Lindore dhe Jugore kanë në funksionim sisteme të pjekura dhe relativisht gjithëpërfshirëse të mbrojtjes sociale, megjithëse përballen me sfida që vijnë nga ndryshimi i natyrës së punës dhe me mangësi në lidhje me mbrojtjen e punëtorëve informalë, migrantëve, popullatave të zhvendosura dhe fëmijëve. Në pjesë të tjera të rajonit, veçanërisht në Azinë Qendrore dhe Kaukaz, sistemet e mbrojtjes sociale përballen me

vështirësi që lidhen me fragmentimin, nivelet e ulëta të shpenzimeve shoqërore publike, mbulimin e kufizuar dhe nivelet e pamjaftueshme të përfitimeve (ILO 2017). Kriza COVID-19 i ka nxjerrë këto sfida në plan të parë si dhe ka nxjerrë në pah nevojën për një planifikim më fleksibël të mbrojtjes sociale të aftë për t'iu përgjigjur një game të gjerë goditjesh të jashtme, por mbi të gjitha për zgjidhje të qëndrueshme për shtrirjen e mbrojtjes sociale në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe sistematike.

# 4 Reagimi i mbrojtjes sociale ndaj pandemisë COVID-19

Pandemia COVID-19 ka ndikuar thellësisht në tregun rajonal të punës, duke çuar në humbje të konsiderueshme të të ardhurave të krahut të punës dhe në zgjerimin e pabarazive sa i takon gjinisë dhe të ardhurave. Një shqetësim i veçantë është situata e të rinjve që nuk janë të angazhuar në arsim, punësim apo kualifikim.

Siç tregohet në tabelën 1, humbja e orëve të punës në Evropë dhe Azinë Qendrore në vitin 2020 u vlerësua në masën 9.2 përqind (ekuivalente me 30 milionë punëtorë me kohë të plotë), që është dukshëm mbi mesataren botërore dhe shkaktoi një

rënie të vlerësuar prej 8.7 përqind në të ardhurat e krahut të punës. Ky ndikim ishte veçanërisht i rëndë në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore dhe Perëndimore.

*Raporti Global i ILO-s për Pagat* nxjerr në pah edhe ekzistencën e trysnisë për uljen e nivelit të pagave në gjysmën e parë të vitit 2020 si rezultat i krizës COVID-19 (ILO 2020b). Gratë dhe punëtorët me pagë më të ulët u prekën në mënyrë disproporcionale, duke rritur kështu pabarazitë gjinore dhe në të ardhura.

► Tabela 1. Humbjet e orëve të punës dhe humbjet e të ardhurave të krahut të punës sipas rajonit, 2020

	<i>Orët e humbura të punës (%)</i>	<i>Numri i barasvlershëm i vendeve të humbura të punës me kohë të plotë (48 orë në javë) (milionë)</i>	<i>Humbja e të ardhurave të krahut të punës (% e të ardhurave të krahut të punës)</i>
Bota	8.8	255	8.3
Evropa dhe Azia Qendrore	9.2	30	8.7
Evropa Veriore	10.0	4	n.a.
Evropa Jugore	12.3	6	n.a.
Evropa Perëndimore	6.9	5	n.a.
Evropa Lindore	7.4	8	8.0*
Azia Qendrore dhe Perëndimore	12.0	7	16.3*

**Shënime:** \* = tre tremujorët e parë të vitit 2020. *n.a.* = jo i disponueshëm.

**Burimi:** (ILO 2021c; 2020d).

Në përgjigje të krizës COVID-19, vendet kanë ndërmarrë ndërhyrje të menjëhershme për shëndetin publik si dhe masa ekonomike për të zbutur ndikimet negative të pandemisë dhe për të nxitur ekonominë. Ato përfshijnë sigurimin e qasjes tek shërbimet shëndetësore, ruajtjen e shërbimeve thelbësore, mbrojtjen e vendeve të punës, ofrimin e ndihmesës për vazhdimësinë e biznesit dhe garantimin e të ardhurave për personat e prekur nga kriza.<sup>6</sup>

Në të gjitha vendet e rajonit, politikat e mbrojtjes sociale kanë qenë pjesë vendimtare e përgjigjeve të integruara ndaj krizës COVID-19. Në veçanti, sistemet ekzistuese të mbrojtjes sociale i kanë ndihmuar qeveritë për të ofruar mbështetje fleksibile në kohën e duhur për punëtorët dhe familjet e tyre të prekura nga kriza pa pasur nevojë të miratojnë ligje dhe rregullore të reja. Tabela 2 përmbledh mënyrat kryesore të reagimit të mbrojtjes sociale dhe vendeve të punës të miratuara nga vendet e rajonit.

<sup>6</sup> Përveç nëse specifikohet ndryshe, informacioni i vendeve në këtë seksion bazohet në burimet kombëtare dhe përmbledhjet ekzistuese (Gentilini, Dale dhe Almenfi 2020; ILO 2021b; 2021f); ju lutemi konsultoni këto burime për një listë të plotë të referencave.

► Tabela 2. Masat e marra në kuadrin e mbrojtjes sociale dhe vendeve të punës për t'iu përgjigjur pandemisë COVID-19

Vendi	Subvencion i përkohshëm i pagës	Lehtësim për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore	Përfitimet në rast sëmundjeje	Pagesat e papunësisë	Përfitimet jo-kontributive në para	Përfitime shtesë në para për pensionistët
Shqipëria	○	...	...	○	○	○
Armenia	△	△	...	△	○	△
Azerbajxhani	△	△	...	△	△	△
Bjellorusia	...	△	...	△	...	△
Bosnja dhe Hercegovina	○	○	...	○	...	△
	RS	○	...	○	...	△
Gjeorgjia	△	△	...	△	△	△
Kazakistani	○	△	...	○	○	△
Kirgistani	○	△	...	△	○	△
Mali i Zi	○	○	...	○	○	○
Maqedonia e Veriut	○	○	...	○	○	○
Republika e Moldavisë	△	○	...	○	○	...
Federata Ruse	△	△	○	○	○	△
Serbia	○	...	...	...	○	○
Taxhikistani	△	△	...	...	△	△
Ukraina	△	△	...	○	○	○
Uzbekistani	○	△	...	○	○	△

**Shënime:** ○ = ndryshime të mëdha në nivelet e përfitimit ose kriteret e kualifikueshmërisë; △ = ndryshime të vogla; ... = asnjë ndryshim. FB&H = Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës. RS = Republika Srpska.

**Burimet:** Përmbledhjet e stafit të ILO-s bazuar në Gentilini, Dale dhe Almenfi 2020; ILO 2021d.

Të gjitha vendet kanë filluar të zbatojnë masa për **mbrojtjen e shëndetit social** duke lehtësuar qasjen tek shërbimet e kujdesit shëndetësor për trajtimin dhe testimin e COVID-19 për të gjithë banorët. Përveç kësaj, disa vende kanë alokuar burime relativisht të mëdha për sistemet e tyre të kujdesit shëndetësor në tërësi.

**Subvencionimi i përkohshëm i pagave**, megjithëse në nivelin e pagës minimale dhe vetëm për një periudhë të kufizuar kohe, kontribuoi në parandalimin e pushimeve masive, kompensimin e punëtorëve për të ardhurat e humbura si rezultat i bllokimit, dhe ruajtjen e marrëdhënieve të punës. Nëse pandemia vazhdon dhe situata e tregut të punës nuk përmirësohet, mund të lindë nevoja për ofrimin përsëri të subvencioneve të tilla të pagave përkohësisht.

**Lehtësimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore**, me anë të subvencionimit ose shtyrjes së tyre, pati një ndikim të rëndësishëm në vazhdimësinë e biznesit, duke pasur parasysh shkallën e kontributeve. Megjithëse reduktimi i përkohshëm i kontributeve të sigurimeve shoqërore plotësonte nevojat e menjëhershme në lidhje me likuiditetin, duke i ndihmuar ndërmarrjet për të vazhduar biznesin dhe për të mbajtur në punë punonjësit, kjo masë pati ndikime të drejtpërdrejta në financimin e skemave të sigurimeve shoqërore, në veçanti në fondet e pensioneve, të cilat tani janë në deficit në shumicën e vendeve me implikime serioze për qëndrueshmërinë e financimit të tyre afatgjatë.

Përdorimi i **përfitimeve në rast sëmundjeje/ për arsye shëndetësore** për punonjësit që nuk ishin në gjendje të punonin për shkak të mbylljes së biznesit ose karantinës së detyrueshme nuk u miratua gjerësisht nga vendet e rajonit. Kjo ndodh pasi punëdhënësit janë të detyruar që të paguajnë për disa nga ditët e para të raportit mjekësor për punonjësit e tyre. Në Kroaci dhe Slloveni, për shembull, shteti pagoi pagat e punonjësve me raport mjekësor që nga dita e parë, gjë që përbën një devijim nga rregulli normal që punëdhënësit duhet të paguajnë për 30 ditët e para. Në Federatën Ruse, niveli i përfitimeve për arsye shëndetësore u rrit për të kapur të paktën nivelin e pagës minimale.

Pandemia përforcoi nevojën e krahutshme për të zgjeruar mbulimin me **pagesat e papunësisë** dhe për të rritur nivelet e përfitimeve. Një numër vendesh në rajon i kanë rritur ndjeshëm pagesat e

papunësisë me qëllim mbulimin e një numri më të madh punëtorësh. Gjithashtu është vënë re se reagimi i mbrojtjes sociale ndaj COVID-19 ka shërbyer si një nxitje për të papunët që të regjistrohen në zyrat publike të punësimin. Për më tepër, një numër vendesh, si Azerbajxhani, Kirgistani, Taxhikistani dhe Uzbekistani, kanë bërë plane për të mbështetur kalimin nga ekonomia informale në atë formale dhe për të zgjeruar mbulimin me mbrojtje sociale në ekonominë informale.

**Përfitimet e ndihmës sociale me karakter jo kontributiv** u rritën përkohësisht, kushtet e kualifikueshmërisë u lehtësuan dhe u ofruan pagesa shtesë të njëhershme në para. Disa vende (për shembull, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) ofruan ndihmë të njëhershme me të ardhura për mbarë shoqërinë me karakter universal. Shumica e vendeve në Azinë Qendrore dhe Kaukaz zgjeruan fushëmbulimin e programeve të ndihmës sociale për të adresuar çështjet që lidhen me gabimet e përjashtimit në skema të kufizuara, duke ulur pragjet e kualifikueshmërisë dhe në disa raste duke shtyrë ri-certifikimin (për shembull, në Azerbajxhan, Kazakistan dhe Uzbekistan). Sidoqoftë, mbulimi nuk u shtri plotësisht tek shumë persona që jetojnë në varfëri ose në rrezik varfërie në këto vende. Nga ana e saj, Federata Ruse rriti ndjeshëm nivelin dhe kohëzgjatjen e pagesës së ndihmës sociale, përfitimin e amësisë dhe pagesën e papunësisë të financuar nga taksat.

Disa vende investuan edhe më tej për **riprojektimin dhe zgjerimin e sistemeve elektronike për menaxhimin e informacionit për të nxitur reformat shumë të nevojshme dhe për të rritur qasjen tek programet e mbrojtjes sociale**. Azerbajxhani ka qenë pararendës në nënrajonin e tij, pasi ka futur në përdorim që herët procedurat e automatizuara dhe të dixhitalizuara të aplikimit për ndihmë sociale, vlerësim të aftësisë së kufizuar dhe skema të tjera. Në përgjigje të ndikimit të COVID-19, ata kanë investuar për projektimin e aplikacionit elektronik për shërbimet e kujdesit në shtëpi për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, duke u mundësuar atyre qasje tek informacioni dhe shërbimet gjatë periudhës së pandemisë (shih kutinë 2). Shqipëria ka zbatuar Regjistrin Elektronik Kombëtar si një element i reformës së saj të ndihmës sociale dhe shërbimeve sociale (shih kutinë 3).

► **Kutia 2: Përmirësimi i reformave dhe mënyrës së ofrimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale duke përdorur sisteme elektronike për menaxhimin e informacionit në Azerbajxhan: *DOST - një sportel i vetëm për shërbimet sociale***

Për të lehtësuar komunikimin e Qeverisë me qytetarët, në vitin 2018 Ministria e Punës dhe Mbrojtjes Sociale së Popullsisë së Republikës së Azerbajxhanit themeloi Agjencinë për Ofertën Sociale të Qëndrueshme dhe Operative, e njohur si *DOST*.

*DOST* është një shërbim me një sportel të vetëm që ndan informacione dhe mundëson qasjen tek 132 shërbime ligjore të mbrojtjes sociale. Ai përdor një sistem të centralizuar për menaxhimin e informacionit i cili koordinon programet dhe aktivitetet e ministrisë, Agjencisë së Shërbimeve Sociale, organeve të qeverisjes vendore dhe ofruesve të tjerë jo-fitimprurës dhe të shërbimeve private. Qytetarët mund të aplikojnë përmes një formulari online ose duke kontaktuar një qendër administruese të thirrjeve telefonike, dhe mund të presin një përgjigje brenda 10-15 minutave, ose në rast të kërkesave shumë komplekse një konfirmim të marrjes së kërkesës dhe një përgjigje gjithëpërfshirëse brenda 7-15 ditëve. Gjatë pandemisë, ky shërbim me një sportel të vetëm ishte tejte i dobishëm për ofrimin e shërbimeve për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara, si dhe për shpërndarjen e pagesave në para për përdoruesit e rinj.

Funksionet e tjera të kryera nga *DOST* përfshijnë: (1) zhvillimin e anketave me personat e grupeve vulnerabël të cilë kanë nevojë për mbrojtje sociale dhe mirëqenie sociale; (2) kryerjen e vlerësimeve të nevojave, paraqitjen e propozimeve për mbrojtjen e të drejtave dhe plotësimin e nevojave të grupeve të pafavorizuara të popullsisë; dhe (3) monitorimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve dhe përgatitjen e propozimeve për përmirësimin dhe zhvillimin e këtyre shërbimeve.

**Burimi:** ILO 2021e; 2021g.

► **Kutia 3. Përmirësimi i reformave dhe mënyrës së ofrimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale duke përdorur sisteme elektronike për menaxhimin e informacionit në Shqipëri: *Regjistri Elektronik Kombëtar, nxitja e zbatimit të reformave të shërbimeve të ndihmës sociale, aftësisë së kufizuar dhe kujdesit***

Që nga viti 2019 dhe në kuadrin e programit të ndihmës ekonomike, Shqipëria ka përdorur Regjistrin Elektronik Kombëtar si dhe ka futur në përdorim një formulë të standardizuar pikëzimi (*proxy means test*) me kritere kualifikueshmërie, përfitime dhe shërbime të reja.

Metodologjia e shënjestrimit e futur në përdorim së fundmi ka minimizuar gabimet në aspektin e përfshirjes. Sidoqoftë, ai ka rezultuar edhe në gabime përjashtimi, duke refuzuar një numër të madh të familjeve që janë të varfra për sa i përket të ardhurave dhe aftësisë së tyre për të plotësuar nevojat bazë. Pas futjes në përdorim të formulës së pikëzimit, numri i familjeve përfituese u ul ndjeshëm, veçanërisht në mesin e familjeve me vetëm një ose dy anëtarë. Për më tepër, janë vënë re dallime të mëdha rajonale sa i takon efektivitetin të aktiviteteve të sensibilizimit dhe komunikimit, dhe pengesave në procesin e regjistrimit.

Qeveria ka ndërmarrë edhe një reformë për programin e ndihmës për aftësinë e kufizuar duke synuar (1) riorientimin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar larg modelit të mëparshëm mjekësor dhe drejt modelit bio-psiko-social të përshtatur me standardet ndërkombëtare; (2) prezantimin e planeve mbështetëse individuale multidisiplinare për personat me aftësi të kufizuara; dhe (3) riorganizimin e administratës për vlerësimin e aftësisë së kufizuar për të përmirësuar efikasitetin dhe për të rritur llogaridhënien duke vendosur kontrolle dhe balanca.

Ligji i vitit 2015 për vetëqeverisjen lokale dhe Ligji i vitit 2016 për shërbimet e kujdesit social kanë vënë në lëvizje një proces në të cilin shërbimet sociale janë decentralizuar nga pushteti qendror në 61 bashki. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit social tani është kryesisht përgjegjësi e pushtetit vendor, me mbështetjen e institucioneve të pushtetit qendror. Megjithatë, shumica e bashkive nuk kanë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për të kryer këtë detyrë.

Shqipëria po përballë me një sfidë të madhe sa i takon përmirësimin të qasjes dhe cilësisë së shërbimeve të integruara të kujdesit social në nivel lokal. Kjo do të kërkojë zhvillimin e kuadrit financiar dhe rregullator përkatës, si dhe të sistemeve administrative dhe ofruese, siç janë standardet e shërbimeve, Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Social dhe Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

**Burimi:** ILO 2021e.

Përveç transfertave në para, është aplikuar edhe dhënia e përfitimeve në natyrë në formën e përjashtimit nga detyrimi për shlyerjen e faturave të shërbimeve komunale ose kuponëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të veçanta. Disa vende filluan të zbatonin edhe lejen e përkohshme të posaçme për **kujdesin ndaj fëmijëve** për ata punonjës që duhej të kujdeseshin për fëmijët që qëndronin në shtëpi në kohën kur shkollat dhe institucionet e kujdesit për fëmijët ishin mbyllur për muaj të tërë.

Në të gjitha vendet, **pagesat e pensioneve** u indeksuan në një masë më të lartë se normat e përcaktuara me ligj dhe pensionet minimale u rritën. Disa vende u paguan pensionistëve shtesa të njëhershme. Përfituesve të pensioneve në Armeni, Bjellorusi dhe Kirgistan iu është dërguar pagesa në vendbanimin e tyre për të zvogëluar rrezikun e ekspozimit ndaj virusit.

Në shumicën e vendeve në Azinë Qendrore dhe Kaukaz, **në skemat e sigurimeve shoqërore kontribuojnë vetëm një pakicë e punëtorëve**. Kjo ndodh pasi shumë punëtorë dhe punëdhënës veprojnë jashtë kuadrit ligjor të skemave të tilla. Në këto vende, humbjet e vendeve të punës dhe mbyllja e vendeve të punës si rezultat i pandemisë mund të rrisin nivelin e punësimit informal dhe të çojnë në përmbysje të arritjeve për uljen e varfërisë. Duke përdorur pragun e varfërisë prej 5,50 dollarë në ditë, Banka Botërore vlerëson se në Evropë dhe në Azinë Qendrore mund të bien në varfëri si pasojë e krizës COVID-19 edhe 5 milion persona të tjerë (Lakner et al. 2021). Kjo do të gjëryejë më tej qëndrueshmërinë e skemave të sigurimeve shoqërore. Punëtorët migrantë të

kthyer në vendet e tyre, pasi kishin humbur punën si rezultat i COVID-19 (kryesisht punëtorë nga Kirgistani, Taxhikistani, dhe Uzbekistani të kthyer nga Kazakistani, Republika e Koresë dhe Federata Ruse) dhe familjet e tyre përballen me një barrë shtesë të konsiderueshme, pasi në shumicën e rasteve ata nuk kualifikohen për asnjë nga programet kombëtare të mbrojtjes sociale.

Nevoja për të vendosur ose forcuar lidhjet midis përfitimeve për mbrojtjen sociale dhe shërbimeve të kujdesit social dhe punësimit për personat që përballen me privime të shumta (krahas vështirësive financiare) dhe punëkërkuësit është bërë më e dukshme, dhe një sërë vendesh (Armenia, Maqedonia e Veriut, Serbia, Taxhikistani dhe Uzbekistani) janë përpjekur të planifikojnë ofrimin e shërbimeve më të integruara.

Sipas vlerësimeve, 14.6 përqind e PBB-së globale ka shkuar për masat fiskale në përgjigje të COVID-19, duke përfshirë shpenzimet shtesë dhe detyrimet kontingjente të grumbulluara në format e injektimit të kapitalit, huave dhe garancive të ndryshme për ndërmarrjet ose të tjerët (shih tabelën 3). Shkalla dhe përparësitë e ndërhyrjeve fiskale ndryshojnë shumë nga njëri vend tek tjetri. Masat fiskale të marra nga vendet në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Azinë Qendrore ishin përgjithësisht më të kufizuara sesa masat e marra nga vendet me të ardhura të larta ose Shtetet e Reja Anëtare të BE-së. Ata u përqëndruan kryesisht tek shpenzimet e drejtpërdrejta shtesë të synuara për ndërmarrjet dhe familjet, megjithëse disa vende (si Republika e Moldavisë, Serbia, Taxhikistani dhe Ukraina) e ndanë një pjesë relativisht të madhe të shpenzimeve për sistemet e tyre të nënfinancuara të kujdesit shëndetësor.



► Tabela 3. Masat fiskale të lidhura me COVID-19 gjatë vitit 2020, vendet e përzgjedhura (% e PBB-së)

Vendi	Shpenzimet shtesë ose të ardhurat e humbura (A)			Shpenzimet e përshpejtuara / të ardhurat e shtyra (B)	Mbështetja e likuiditetit (C)				Totali A+B+C (totali i të dhënave të disponueshme)*
	Nëntotali	Spektori shëndetësor	Spektori joshëndetësor		Nëntotali	Injektimet e kapitalit, huatë, blerja e aktiveve ose supozimet e borxhit	Detyrimet kontingjente		
							Garancitë	Operacionet pothuajse-fiskale	
<b>Evropa Qendrore dhe Lindore</b>									
Shqipëria	1.2	0.2	0.9	–	1.7	–	1.7	–	2.9
Bosnja dhe Hercegovina	5.1	–	–	–	–	–	–	–	5.1
Mali i Zi	8.0	0.5	7.6	2.3	–	–	0.0	–	10.3
Maqedonia e Veriut	2.9	0.1	2.8	–	2.9	–	–	2.9	5.8
Republika e Moldavisë	2.2	1.2	1.1	–	0.4	0.3	0.0	–	2.6
Serbia	5.6	1.3	4.3	2.8	1.4	–	1.0	0.4	9.8
Ukraina	3.4	0.9	2.5	–	–	–	–	–	3.4
<b>Evropa Lindore dhe Azia Qendrore</b>									
Armenia	1.0	0.3	0.7	0.0	1.1	1.1	0.0	0.0	2.0
Azerbajxhani	2.2	0.5	1.6	–	3.4	2.7	0.7	0.0	5.6
Kazakistani	2.4	–	–	–	3.1	1.9	–	1.2	5.5
Kirgistani	6.1	0.3	5.8	–	–	–	–	–	6.1
Rusia	2.9	0.6	2.3	0.4	1.5	0.5	0.5	0.5	4.9
Taxhikistani	3.0	1.9	1.1	–	0.5	0.5	–	–	3.5
Uzbekistani	3.7	0.8	3.0	–	2.4	2.4	–	–	6.1
Bota	7.4	1.0	6.4	1.0	6.1	0.4	4.0	1.6	14.6

**Shënime:** Vlerësimet deri në fund të muajit dhjetor 2020. Zbatimi i masave mund të vazhdojë gjatë gjithë vitit 2020, 2021 ose më gjërë. Përqindjet e PBB-së bazohen në *Përditësimin e Perspektivës Ekonomike Botërore* të muajit janar 2021, përveç nëse thuhet ndryshe. Vlerësimi global i mbështetjes fiskale përfshin shpenzimet shtesë dhe të ardhurat e humbura, si dhe detyrimet kontingjente nga garancitë dhe operacionet pothuajse-fiskale  
\* Shifrat nuk mund të mos korrespondojnë në mënyrë të saktë me numrat e dhënë në kolonat totale për shkak të rrumbullakimit.

**Burimet:** Autoritetet kombëtare dhe vlerësimet e stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN 2021).

# 5 Përfundimi: Drejt një sistemi gjithëpërfshirës dhe rezilient të sigurimeve shoqërore

Në të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Azisë Qendrore, mbrojtja sociale ka luajtur një rol jetik për reagimin ndaj krizës COVID-19. Sidoqoftë, kriza ka zbuluar edhe disa mangësi sa i takon mbulimit, përshtatshmërisë dhe gjithëpërfshirjes në sistemet ekzistuese të mbrojtjes sociale që burojnë nga çështjet e qenësishme në botën e punës që mbizotëron aktualisht, veçanërisht në lidhje me rritjen e punësimit të pasigurt dhe zgjerimin e pabarazisë. Në të njëjtën kohë, kriza ka nxjerrë në pah rëndësinë e investimeve proaktive për të ndërtuar sisteme gjithëpërfshirëse dhe elastike për mbrojtjen sociale. Mësimet kryesore të nxjerra deri më tani mund të përmbliidhen si më poshtë.

**Mbulimi me sigurime shoqërore duhet të shtrihet tek punëtorët në të gjitha llojet e punësimit, përfshirë punëtorët në ekonominë informale dhe ata në forma jo standarde të punësimit, si në ekonominë e platformave, por edhe tek punëtorët migrantë.** Kjo kërkon marrjen parasysh të heterogjenitetit të gjerë të popullsisë aktive dhe të niveleve të larta të lëvizshmërisë së tregut të punës. Respektimi ligjor dhe zbatimi i mbledhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore duhet të përmirësohet duke nxjerrur formalizimin e punëtorëve në ekonominë informale dhe duke adresuar nën-raportimin e pagave që janë objekt i kontributeve. Përpjekjet fillestare drejt mbështetjes së kalimit nga ekonomia informale në atë formale të ndërmarra në Azerbajxhan, Taxhikistan dhe Uzbekistan duhet të promovohen më tej së bashku me shtrirjen e mbulimit të mbrojtjes sociale tek punëtorët në ekonominë informale.

**Sigurimi i burimeve të mjaftueshme dhe identifikimi i hapësirave fiskale janë të domosdoshme në mënyrë që sistemet e mbrojtjes sociale të garantojnë qasjen efektive tek siguria e të ardhurave dhe kujdesi shëndetësor.** Masat e fundit për stimulimin dhe mbrojtjen sociale i kanë vënë në sprovë të vështirë buxhetet qeveritare dhe kanë ndikuar në qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemeve të mbrojtjes sociale, në veçanti të sistemeve tashmë të brishta të pensioneve. Megjithatë, investimi për mbrojtjen sociale është i një rëndësie vendimtare për arritjen e rimëkëmbjes

ekonomike dhe ndërtimin e sistemeve që do të jenë më reziliente përballë goditjeve të ardhshme. Megjithëse tani ruajtja e një politike fiskale sa më fleksibël dhe mbështetëse është kritike, është po aq e rëndësishme që qeveritë të krijojnë dhe sigurojnë hapësirë fiskale për të ruajtur dhe përmirësuar sistemet e mbrojtjes sociale gjatë krizës, fazës së rimëkëmbjes dhe përtej saj.

**Një sfidë tjetër kryesore është përmirësimi i financimit të mbrojtjes sociale përmes kombinimit të burimeve të financimit kontributive dhe jo kontributive.** Kriza COVID-19 ka bërë që qeveritë të marrin në konsideratë rregullimin e arkitekturës së tyre ekzistuese të sigurimeve shoqërore dhe të kërkojnë një kombinim më të përshtatshëm të sistemeve kontributive dhe jo kontributive të cilat i përgjigjen më mirë transformimit të vazhdueshëm të tregut të punës. Për shembull, mbyllja e hendekut financiar vjetor në Evropën Lindore në vitin 2020, dhe përbushja e Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm 1.3 dhe 3.8, do të kishin kërkuar një shumë shtesë prej 227.1 miliardë dollarësh për të financuar plotësisht koston totale të një grupi përfitimesh universale që mund të përbëjnë dyshemenë e mbrojtjes sociale në këtë nënrajon. Kjo përfaqëson një investim shtesë prej 2.7 përqind të PBB-së së këtyre vendeve (ILO 2020c). Përfitimet nga skemat jo kontributive duhet të plotësojnë në mënyrë efektive programet kontributive për të plotësuar mangësitë në aspektin e mbulimit.

**Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet forcimit të kapaciteteve të ministrive përgjegjëse për mbrojtjen sociale, institucioneve të sigurimeve shoqërore dhe agjencive në nivele kombëtare dhe nënkombëtare, me qëllim organizimin e komponentëve kontributiv dhe jo kontributiv në një sistem të vetëm.** Hartimi i kujdesshëm i politikave, qeverisja strategjike dhe mekanizmat e mirë-organizuar, përfshirë sistemet elektronike për menaxhimin e informacionit, do të nevojiten për të garantuar zgjerimin e mbulimit, monitorimin e tendencave dhe aftësimin e sistemeve kombëtare të mbrojtjes sociale për t'iu përgjigjur në mënyrë fleksibile goditjeve dhe nevojave në ndryshim të popullsisë.

**Gjatë krizës u identifikua edhe nevoja për reagimin e integruar të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të punësimit.** Zgjidhjet e integruara kërkojnë të projektojnë një kombinim sa më të përshtatshëm të programeve të mbrojtjes sociale dhe punësimit që mund t'u përgjigjen të drejtave dhe nevojave të punëtorëve dhe njerëzve të tjerë dhe t'i mbështesin ata përmes tranzicioneve të ndryshme dhe gjithnjë e më komplekse në jetë dhe punë.

**Kriza ka përforcuar edhe nevojën që grupet trepalëshe të interesit - qeveritë, punëtorët dhe punëdhënësit - të adresojnë së bashku problemin e COVID-19 përmes dialogut efektiv social dhe të rrisin koordinimin me autoritetet financiare për të formuluar masat e duhura për reagimin e sistemit të sigurimeve shoqërore ndaj krizës.** Në disa vende puna dhe koordinimi i përbashkët kanë qenë të dukshme. Për shembull, në Azerbajxhan është

formuar një grup pune i kryesuar nga Ministria e Punës dhe Mbrojtjes Sociale me pjesëmarrjen e partnerëve socialë me qëllim përcaktimin e kritereve për të ndihmuar bizneset dhe promovuar punësimin; në Gjeorgji, Konfederata e Sindikatave Gjeorgjiane propozoi ndryshime të ligjit të punës që lejojnë shlyerjen e pagave për punëtorët në karantinë dhe krijimin e një fondi të posaçëm për të luftuar pandeminë, të cilat janë miratuar tashmë. Masa të tilla mund të përsëriten në mënyrë të dobishme në riprojektimin e sistemeve të tjera të mbrojtjes sociale për t'i ndihmuar vendet për t'iu përgjigjur sfidave të reja. Një zgjidhje e qëndrueshme për çështjet e nxjerra në dritë nga pandemia mund të arrihet dhe të mbështetet vetëm nëse ekziston konsensusi shoqëror mbarëkombëtar i bazuar në një perceptim të plotë të implikimeve të masave dhe përmes angazhimit të vazhdueshëm të të gjithë aktorëve përkatës.

- Bradshaw, Jonathan, dhe Kenichi Hirose. 2016. *Child Benefits in Central and Eastern Europe: A Comparative Review*. (Përfitimet e Fëmijëve në Evropën Qendrore dhe Lindore: Një Përmbledhje Krahasuese). Budapest: Ekipi i ILO-s për Punën e Denjë dhe Zyra Kombëtare për Evropën Qendrore dhe Lindore. [Bradshaw, Jonathan, and Kenichi Hirose. 2016. *Child Benefits in Central and Eastern Europe: A Comparative Review*. Budapest: ILO DWT and Country Office for Central and Eastern Europe.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/-/europe/-/ro-geneva/-/sro-budapest/documents/publication/wcms\\_532424.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/-/europe/-/ro-geneva/-/sro-budapest/documents/publication/wcms_532424.pdf).
- Gentilini, Ugo, Pamela Dale, dhe Mohamed Almenfi. 2020. *Social Protection and Jobs Responses to COVID-19: A Real-Time Review of Country Measures*. (Përgjigja e Mbrojtjes Sociale dhe e Vendeve të Punës ndaj COVID-19: Vlerësimi në kohë reale i Masave Kombëtare (11 dhjetor 2020). Teksti/Versioni HTML 14. [Gentilini, Ugo, Pamela Dale, and Mohamed Almenfi. 2020. "Social Protection and Jobs Responses to COVID-19: A Real-Time Review of Country Measures (December 11, 2020)". Text/HTML version 14.] <https://documents1.worldbank.org/curated/en/467521607723220511/pdf/Social-Protection-and-Jobs-Responses-to-COVID-19-A-Real-Time-Review-of-Country-Measures-December-11-2020.pdf>.
- Hirose, Kenichi. 2019. *Health Care Financing Reform in Ukraine – A Progress Review, 2016–2019*. (Reforma për Financimin e Kujdesit Shëndetësor në Ukrainë - Vlerësimi i Progresit, 2016–2019). Shënime të shaptilografuara. [Hirose, Kenichi. 2019. "Health Care Financing Reform in Ukraine – A Progress Review, 2016–2019". Mimeographed notes.]
- ILO. 2017. *World Social Protection Report 2017–19: Universal Social Protection to Achieve the Sustainable Development Goals*. (Raporti Botëror për Mbrojtjen Sociale 2017–19: Mbrojtja Universale Sociale për të Arritur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm). [ILO. 2017. *World Social Protection Report 2017–19: Universal Social Protection to Achieve the Sustainable Development Goals*.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/-/dgreports/-/dcomm/-/publ/documents/publication/wcms\\_604882.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/-/dgreports/-/dcomm/-/publ/documents/publication/wcms_604882.pdf).
- ———. 2020a. *Assessment of the Impact of COVID-19 on the Socio-Economic Situation in Uzbekistan: Income, Labour Market and Access to Social Protection. Overview of Crisis Measures and Ways to Improve State Policy*. (Vlerësimi i Ndikimit të COVID-19 në Situatën Social-Ekonomike në Uzbekistan: Të Ardhurat, Tregu i Punës dhe Qasja tek Mbrojtja Sociale. Pasqyrë e Masave kundër Krizës dhe Mënyrave për Përmirësimin e Politikës Shtetërore). [———. 2020a. *Assessment of the Impact of COVID-19 on the Socio-Economic Situation in Uzbekistan: Income, Labour Market and Access to Social Protection. Overview of Crisis Measures and Ways to Improve State Policy*.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/-/europe/-/ro-geneva/-/sro-moscow/documents/publication/wcms\\_759842.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/-/europe/-/ro-geneva/-/sro-moscow/documents/publication/wcms_759842.pdf).
- ———. 2020b. *Global Wage Report 2020–21: Wages and Minimum Wages in the Time of COVID-19*. (Raporti Global për Pagat 2020–21: Pagat dhe Pagat Minimale në Kohën e COVID-19). [———. 2020b. *Global Wage Report 2020–21: Wages and Minimum Wages in the Time of COVID-19*.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/-/dgreports/-/dcomm/-/publ/documents/publication/wcms\\_762534.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/-/dgreports/-/dcomm/-/publ/documents/publication/wcms_762534.pdf).
- ———. 2020c. *Financing Gaps in Social Protection: Global Estimates and Strategies for Developing Countries in Light of COVID-19 and Beyond. Social Protection Spotlight*. (Mungesa e Financimit për Mbrojtjen Sociale: Vlerësimet dhe Strategjitë Globale për Vendet në Zhvillim në Dritën e COVID-19 dhe më Gjerë. Prozhektorët mbi Mbrojtjen Sociale.) 17 shtator 2020. [———. 2020c. "Financing Gaps in Social Protection: Global Estimates and Strategies for Developing Countries in Light of COVID-19 and Beyond". Social Protection Spotlight. 17 September 2020. ] <https://www.social-protection.org/gimi/RessourcePDF.action?id=56836>

- ▶ ———. 2020d. *ILO Monitor: COVID-19 and the World of Work*, 6th ed. *Updated Estimates and Analysis*. (Monitori i ILO-s: COVID-19 dhe Bota e Punës, edicioni i 6-të. Vlerësimet dhe Analiza e Përditësuar). [———. 2020d. *ILO Monitor: COVID-19 and the World of Work*, 6th ed. *Updated Estimates and Analysis*.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/documents/briefingnote/wcms\\_755910.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/documents/briefingnote/wcms_755910.pdf).
- ▶ ———. 2021a. *World Social Protection Report 2020–22: Social Protection at the Crossroads – in Pursuit of a Better Future*. (Raporti Botëror për Mbrojtjen Sociale 2020–22: Mbrojtja Sociale në Udhëkryq - në Kërkim të një të Ardhmeje më të Mirë) [———. 2021a. *World Social Protection Report 2020–22: Social Protection at the Crossroads – in Pursuit of a Better Future*.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@dcomm/@publ/documents/publication/wcms\\_817572.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@dcomm/@publ/documents/publication/wcms_817572.pdf).
- ▶ ———. 2021b. *World Employment and Social Outlook 2021: The Role of Digital Labour Platforms in Transforming the World of Work*. (Perspektiva Botërore për Punësimin dhe Aspektet Sociale 2021: Roli i Platformave Digjitale të Punës në Transformimin e Botës së Punës). [———. 2021b. *World Employment and Social Outlook 2021: The Role of Digital Labour Platforms in Transforming the World of Work*.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/---publ/documents/publication/wcms\\_771749.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/---publ/documents/publication/wcms_771749.pdf).
- ▶ ———. 2021c. *ILO Monitor: COVID-19 and the World of Work*, 7th ed. *Updated Estimates and Analysis*. (Monitori i ILO-s: COVID-19 dhe Bota e Punës, edicioni i 7-të. Vlerësimet dhe Analiza e Përditësuar). [———. 2021c. *ILO Monitor: COVID-19 and the World of Work*, 7th ed. *Updated Estimates and Analysis*.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/documents/briefingnote/wcms\\_767028.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/documents/briefingnote/wcms_767028.pdf).
- ▶ ———. 2021d. *Social Protection Monitor: Social Protection Responses to the COVID-19 Crisis around the World*. (Monitori i Mbrojtjes Sociale: Përgjigjet e Mbrojtjes Sociale ndaj Krizës COVID-19 në të gjithë Botën) [———. 2021d. *Social Protection Monitor: Social Protection Responses to the COVID-19 Crisis around the World*.] <https://www.social-protection.org/gimi/ShowWiki.action?id=3426>.
- ▶ ———. 2021e. *Review of Social Protection System in Albania: Coverage, Expenditure, Adequacy and Financing*. (Një Analizë e Sistemit të Mbrojtjes Sociale në Shqipëri: Mbulimi, Shpenzimet, Përshtatshmëria dhe Financimi.) Budapest. [———. 2021e. *Review of Social Protection System in Albania: Coverage, Expenditure, Adequacy and Financing*. (Një Analizë e Sistemit të Mbrojtjes Sociale në Shqipëri: Mbulimi, Shpenzimet, Përshtatshmëria dhe Financimi.) Budapest.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms\\_798635.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_798635.pdf).
- ▶ ———. 2021f. *Assessment of the Social Security Responses to COVID-19 Lessons from the Western Balkans and Eastern Europe during the First Stage of the Pandemic*. (Vlerësimi i Përgjigjes së Sigurimeve Shoqërore ndaj Mësimeve të COVID-19 nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Lindore gjatë Fazës së Parë të Pandemisë) [———. 2021f. *Assessment of the Social Security Responses to COVID-19 Lessons from the Western Balkans and Eastern Europe during the First Stage of the Pandemic*.] [https://www.ilo.org/budapest/what-we-do/publications/WCMS\\_775160/lang--en/index.htm](https://www.ilo.org/budapest/what-we-do/publications/WCMS_775160/lang--en/index.htm).
- ▶ ———. ILO. 2021g. Së shpejti. *Mapping social protection services in Azerbaijan*. (Hartëzimi i shërbimeve të mbrojtjes sociale në Azerbajxhan). [———. 2021g. Forthcoming. *Mapping social protection services in Azerbaijan*.]
- ▶ ILO dhe UN Women. Së shpejti. *Social Protection Floors Assessment in Armenia*. (Vlerësimi i Dyshemeve të Mbrojtjes Sociale në Armeni). [ILO and UN Women. Forthcoming. *Social Protection Floors Assessment in Armenia*.]


- ILO, UNICEF, dhe Banka Botërore. 2020. *An Assessment of the Social Protection System in Uzbekistan Based on the Core Diagnostic Instrument (CODI)*. (Vlerësimi i Sistemit të Mbrojtjes Sociale në Uzbekistan bazuar në Instrumentin Kryesor Diagnostikues (CODI)). [ILO, UNICEF (United Nations Children's Fund), and World Bank. 2020. *An Assessment of the Social Protection System in Uzbekistan Based on the Core Diagnostic Instrument (CODI)*.] [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-moscow/documents/publication/wcms\\_760153.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-moscow/documents/publication/wcms_760153.pdf).
- FMN. 2021. *Fiscal Monitor Database of Country Fiscal Measures in Response to the COVID-19 Pandemic*. (Baza e të Dhënave të Monitorimit Fiskal të Masave Kombëtare Fiskale në Përgjigje të Pandemisë COVID-19). Korrik. [IMF (International Monetary Fund). 2021. "Fiscal Monitor Database of Country Fiscal Measures in Response to the COVID-19 Pandemic". July.] <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Fiscal-Policies-Database-in-Response-to-COVID-19>.
- Kidd, Stephen dhe Björn Gelders. 2015. *Child Wellbeing and Social Security in Georgia: The Case for Moving to a More Inclusive National Social Security System*. (Mirëqenia e Fëmijëve dhe Sigurimet Shoqërore në Gjeorgji: Rasti për Kalimin drejt një Sistemi më Gjithëpërfshirës të Sigurimeve Shoqërore Kombëtare). Tbilisi: UNICEF. [Kidd, Stephen and Björn Gelders. 2015. *Child Wellbeing and Social Security in Georgia: The Case for Moving to a More Inclusive National Social Security System*. Tbilisi: UNICEF.] [http://socialprotection-humanrights.org/wp-content/uploads/2016/04/UNICEF\\_Child\\_Wellbeing\\_ENG\\_.pdf](http://socialprotection-humanrights.org/wp-content/uploads/2016/04/UNICEF_Child_Wellbeing_ENG_.pdf).
- Lakner, Christoph, Nishant Yonzan, Daniel Gerszon Mahler, R. Andres Castaneda Aguilar, dhe Haoyu Wu. 2021. *Updated Estimates of the Impact of COVID-19 on Global Poverty: Looking Back at 2020 and the Outlook for 2021*. (Vlerësimet e Përditësuara të Ndikimit të COVID-19 në Varfërinë Globale: Hedhim vështrimin prapa në vitin 2020 dhe Perspektiva për vitin 2021). Blog i të Dhënave të Bankës Botërore (blog). 11 janar 2021. [Lakner, Christoph, Nishant Yonzan, Daniel Gerszon Mahler, R. Andres Castaneda Aguilar, and Haoyu Wu. 2021. "Updated Estimates of the Impact of COVID-19 on Global Poverty: Looking Back at 2020 and the Outlook for 2021". *World Bank Data Blog* (blog). 11 January 2021.] <https://blogs.worldbank.org/opendata/updated-estimates-impact-covid-19-global-poverty-looking-back-2020-and-outlook-2021>.
- UNICEF. 2014. *Children of the Recession: The Impact of the Economic Crisis on Child Well-Being in Rich Countries*. (Fëmijët e Recesionit: Ndikimi i Krizës Ekonomike në Mirëqenien e Fëmijëve në Vendet e Pasura). [UNICEF (United Nations Children's Fund). 2014. *Children of the Recession: The Impact of the Economic Crisis on Child Well-Being in Rich Countries*.] <http://www.unicef-irc.org/publications/pdf/rc12-eng-web.pdf>.
- ———. 2015. *Social Monitor: Social Protection for Child Rights and Well-Being in Central and Eastern Europe, the Caucasus and Central Asia*. (Monitori Social: Mbrojtja Sociale për të Drejtat dhe Mirëqenien e Fëmijëve në Evropën Qendrore dhe Lindore, Kaukazin dhe Azinë Qendrore). [———. 2015. *Social Monitor: Social Protection for Child Rights and Well-Being in Central and Eastern Europe, the Caucasus and Central Asia*.] [https://www.unicef.org/eca/media/1081/file/Social\\_Monitor\\_Regional\\_Report.pdf](https://www.unicef.org/eca/media/1081/file/Social_Monitor_Regional_Report.pdf).
- ———. 2019. *Building a National Social Protection System Fit for Uzbekistan's Children and Young People*. (Ndërtimi i Sistemit Kombëtar të Mbrojtjes Sociale të Përshtatshme për Fëmijët dhe të Rinjtë e Uzbekistanit). [———. 2019. *Building a National Social Protection System Fit for Uzbekistan's Children and Youth*. Tashkent.] [https://www.unicef.org/uzbekistan/media/2761/file/Uzbekistan%20SP%20overview%20paper%20-%20ENG%20FINAL\\_July2019%20.pdf](https://www.unicef.org/uzbekistan/media/2761/file/Uzbekistan%20SP%20overview%20paper%20-%20ENG%20FINAL_July2019%20.pdf).
- ———. 2020. *Universal Child Benefits in Europe and Central Asia*. (Përfitimet Universale të Fëmijëve në Evropë dhe Azinë Qendrore). Përmbledhje Rajonale për Mbrojtjen Sociale Nr. 4. Zyra Rajonale e Evropës dhe Azisë Qendrore. [———. 2020. "Universal Child Benefits in Europe and Central Asia". Regional Social Protection Brief No. 4. Europe and Central Asia Regional Office.] <https://www.unicef.org/eca/media/13446/file/UCB%20in%20Europe%20and%20Central%20Asia%20English%20.pdf>.

## Rritja e drejtësisë sociale, nxitja e punës së denjë

---

Organizata Ndërkombëtare e Punës është agjencia e Kombeve të Bashkuara për botën e punës. Ne bëjmë bashkë qeveritë, punëdhënësit dhe punëmarrësit për një qasje me në qendër njeriun drejt të ardhmes së punës, përmes krijimit të punësimit, të drejtave në punë, mbrojtjes sociale dhe dialogut social.




Ky raport shoqëruar rajonal synon të plotësojë Raportin Botëror të ILO për Mbrojtjen Sociale 2020-22. Ai përfshin një seksion përmbledhës të statusit të mbrojtjes sociale në "Perspektivën Globale" duke vijuar nga një tjetër seksion i cili nxjerr në pah zhvillimet kryesore të mbrojtjes sociale, sfidat dhe prioritetet rajonale në perspektivën e ciklit jetësor.



[ilo.org](http://ilo.org)

---

**International Labour Organization**  
Route des Morillons 4  
1211 Geneva 22  
Switzerland

 International Labour Organization  
 @ILO  
 ILOTV